



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS – VLADA KOSOVA – GOVERNMENT OF KOSOVO  
MINISTRIA E FINANCAVE – MINISTARSTVO FINANSIJE – MINISTRY OF FINANCE



## NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE

### RAPORTI VJETOR 2019

Prishtinë, Mars 2020



**NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE  
FINANSIJSKA OBAVEŠTAJNA JEDINICA  
FINANCIAL INTELLIGENCE UNIT**

**RAPORTI VJETOR 2019**

# PËRMBAJTJA

|   |           |
|---|-----------|
| <b>1. HYRJA</b> .....   | <b>8</b>  |
| <b>2. ORGANIZIMI I NJIF KOSOVA</b> .....  | <b>9</b>  |
| <b>2.1. Buxheti dhe Prokurimi</b> .....   | <b>9</b>  |
| 2.1.1. Buxheti.....   | 9         |
| 2.1.2. Aktivitetet e Prokurimit.....  | 10        |
| <b>2.2. Organizimi i NJIF-K</b> .....   | <b>10</b> |
| 2.2.1. Mbikëqyrja e NJIF-K, burimet njerëzore dhe Struktura organizative e NJIF-K.....                      | 10        |
| <b>3. ZHVILLIMET LIGJORE PËR PPP/LFT</b> .....  | <b>13</b> |
| <b>4. ANALIZA DHE INTELIGJENCA</b> .....  | <b>15</b> |
| 4.1.1. Të dhënat dhe raportet e proceduara.....   | 15        |
| 4.1.2. Raportimi i Transaksioneve/Aktiviteteve të Dyshimta (RTD/RAD).....                                   | 16        |
| 4.1.2.1. <i>Indikatorët e Përgjithshëm dhe specifikë për PPP/LFT</i> .....                                  | 21        |
| 4.1.2.2. <i>Raportimi i Transaksioneve në para të gatshme (RTG)</i> .....                                   | 22        |
| 4.1.3. Raportimi i Deklarimit Kufitar (Qarkullimi i mjeteve monetare brenda dhe jashtë Kosovës).....        | 23        |
| 4.1.4. Ngrirja e transaksioneve bankare.....  | 27        |
| 4.1.5. Analizimi i raporteve të inteligjencës.....  | 28        |
| 4.1.6. Shpërndarja e raporteve të inteligjencës.....  | 29        |
| <b>4.2. Mbikëqyrja e Pajtueshmërisë</b> .....   | <b>33</b> |
| 4.2.1. Ndëshkimet administrative dhe masat për përmirësim.....  | 35        |
| 4.2.2. Aprovimi i zyrtarit të pajtueshmërisë për PPP/LFT.....   | 36        |
| 4.2.3. Udhëzimet, të dhënat statistikore dhe informatat kthyesë.....  | 36        |
| <b>4.3. Aktivitetet e trajnimeve dhe implementimi i Programit të Trajnimeve</b> .....                       | <b>37</b> |
| <b>4.4. Ngritja e kapaciteteve të NJIF-K</b> .....  | <b>38</b> |
| 4.4.1. Teknologjia Informative.....   | 38        |
| 4.4.2. Trajnime, konferenca, seminare dhe takime tjera të ndjekura nga personeli i NJIF-K.....              | 38        |
| 4.4.2.1. <i>Vizitat Studimore</i> .....   | 39        |
| <b>5. BASHKËPUNIMI VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR</b> .....  | <b>41</b> |
| 5.1. Bashkëpunimi dhe koordinimi vendor.....  | 41        |
| 5.2. Bashkëpunimi me homologët e huaj dhe Grupin Egmont.....  | 42        |
| 5.2.1. Shkëmbimi ndërkombëtar i informacioneve.....   | 44        |
| <b>6. MENAXHIMI I RREZIKUT NË PASTRIM TË PARAVE DHE FINANCIM TË TERRORIZMIT</b> 48                          | <b>48</b> |
| 6.1. Strategjitë Kombëtare dhe Planet e Veprimit për PPP/LFT.....   | 48        |
| 6.2. Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar për PP/FT.....   | 49        |
| <b>7. MBËSHTETJA NDËRKOMBËTARE</b> .....  | <b>50</b> |
| 7.1. Projektet e financuar nga BE-ja&KiE.....   | 50        |
| 7.1.1. Projekti i KiE&BE "iPROCEEDS" 2.....   | 52        |
| 7.2. Mbështetja nga UNDP.....   | 52        |
| 7.3. Mbështetja nga CEPOL-it.....   | 54        |
| <b>8. PLANI I PERFORMANCËS DHE RESURSEVE TË NJIF-K</b> .....  | <b>56</b> |
| 8.1. Objektivat për të ardhmen në përmbushjen e planit të performances dhe strategjive tjera kombëtare..... | 56        |



## LISTA E TABELAVE

|                   |  |
|-------------------|--|
| <b>Tabela 1:</b>  | <b>Tabela e ndarjeve dhe realizimit të buxhetit 2019</b>   |
| <b>Tabela 2:</b>  | <b>Numri i raporteve të proceduara përmes sistemit elektronik dhe online 2016-2019</b>                             |
| <b>Tabela 3:</b>  | <b>Numri i RTD-ve të raportuara sipas sektorëve 2015-2019</b>  |
| <b>Tabela 4:</b>  | <b>Informacionet për raportet e dyshimta (RTD) për FT të pranuar nga NJIF-K 2013-2019</b>                          |
| <b>Tabela 5:</b>  | <b>Indikatorët e PP/FT</b>   |
| <b>Tabela 6:</b>  | <b>Raportet në lidhje me transaksionet mbi pragun e raportimit (RTG) sipas sektorëve '15-'19</b>                   |
| <b>Tabela 7:</b>  | <b>Deklarimi i mjeteve monetare në pikat kufitare 2014-2019</b>  |
| <b>Tabela 8:</b>  | <b>Deklarimi i mjeteve monetare brenda dhe jashtë Kosovës 2019</b>   |
| <b>Tabela 9:</b>  | <b>Deklarimi i mjeteve monetare (valutat kryesore) në pikat kufitare Deklarimet sipas llojit të bizneseve 2019</b> |
| <b>Tabela 10:</b> | <b>Ngrirja e Llogarisë/Transaksionit 2014-2019</b>   |
| <b>Tabela 11:</b> | <b>Rastet e Hapura 2015-2019</b>   |
| <b>Tabela 12:</b> | <b>Raportet e inteligjencës të shpërndara/referuara në institucione përkatëse 2014-2018</b>                        |
| <b>Tabela 13:</b> | <b>Inspektimi i Pajtushmërisë sipas llojit 2019</b>  |
| <b>Tabela 14:</b> | <b>Inspektimi i Pajtushmërisë në vend dhe nga distanca 2014-2019</b>   |
| <b>Tabela 15:</b> | <b>Ndëshkimet administrative dhe masat për përmirësim 2019</b>   |
| <b>Tabela 16:</b> | <b>Informatat Kthyes nga Institucionet tjera për NJIF-K 2017-2019</b>  |
| <b>Tabela 17:</b> | <b>Trajnimet për Subjektet Raportuese 2019</b>   |
| <b>Tabela 18:</b> | <b>Shkëmbimi ndërkombëtar i informatave 2015-2019</b>  |
| <b>Tabela 19:</b> | <b>MoU të nënshkruara nga NJIF-K me homologët e huaj</b>   |
| <b>Tabela 20:</b> | <b>Aktivitetet e trajnimeve/punëtorive/vizitat nga stafi i NJIF-K për vitin 2019</b>                               |

## LISTA E GRAFIKËVE

|                    |  |
|--------------------|--|
| <b>Grafiku 1:</b>  | <b>Burimet njerëzore të NJIF-K</b>   |
| <b>Grafiku 2:</b>  | <b>Dinamika e raporteve të proceduara në 2016-2019</b>                                     |
| <b>Grafiku 3:</b>  | <b>Numri i RTD-ve të raportuara 2011-2019</b>  |
| <b>Grafiku 4:</b>  | <b>Numri i RTD-ve të raportuara sipas sektorëve 2019</b>                                   |
| <b>Grafiku 5:</b>  | <b>RTD të raportuara për FT 2013-2019</b>  |
| <b>Grafiku 6:</b>  | <b>Numri i RTG-ve të pranuar 2013-2019</b>   |
| <b>Grafiku 7:</b>  | <b>Deklarimi bazuar në valutat kryesore 2019</b>   |
| <b>Grafiku 8:</b>  | <b>Deklarimi sipas llojit të bizneseve 2019</b>  |
| <b>Grafiku 9:</b>  | <b>Ngrirja e Llogarisë/Transaksionit 2014-2019</b>   |
| <b>Grafiku 10:</b> | <b>Raportet e shpërndara të inteligjencës 2014-2019</b>                                    |
| <b>Grafiku 11:</b> | <b>Inspektimi i Pajtushmërisë sipas llojit 2019</b>  |
| <b>Grafiku 12:</b> | <b>Kërkesat për informata (IRD) të parashtruar nga institucionet bashkëpunuese të NJIF</b> |
| <b>Grafiku 13:</b> | <b>Kërkesat e huaja të pranuar nga NJIF-K</b>  |
| <b>Grafiku 14:</b> | <b>Kërkesat e dërguara nga NJIF-K tek homologët e huaj</b>                                 |
| <b>Grafiku 15:</b> | <b>Numri mesatar i ditëve për t'iu përgjigjur kërkesave të huaja</b>                       |
| <b>Grafiku 16:</b> | <b>Ndarja spontane e informacionit 2013-2019</b>   |

## LISTA E SHKURTESAVE

|           |  |
|-----------|--|
| NJIF      | Njësia për Inteligjencë Financiare                                       |
| PPP       | Parandalimi i Pastrimit të Parave  |
| LFT       | Luftimi i Financimit të Terrorizmit                                      |
| LPP/LFT   | Luftimi i Pastrimit të Parave/Luftimi i Financimit të Terrorizmit        |
| AIF       | Raporti i informacioneve shtesë  |
| AK        | Agjencia Kadastrale e Kosovës  |
| AKI       | Agjencia e Kosovës për inteligjencë                                      |
| AKK       | Agjencia kundër Korrupsionit   |
| AAPSK     | Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar      |
| ARBK      | Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë                           |
| ARC       | Agjencia për Regjistrim Civil  |
| ATK       | Administrata Tatimore e Kosovës  |
| BE        | Bashkimi Evropian  |
| BPCJF     | Bizneset dhe Profesionet e Caktuara Jofinanciare                         |
| BQK       | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës                                   |
| DBJN      | Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar                        |
| DHKEK     | Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (brenda PK)   |
| DK        | Dogana e Kosovës   |
| DKT       | Drejtoria kundër Terrorizmit – (brenda PK)                               |
| DRNOJQ    | Departamenti për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ-të                     |
| EGMONT    | Rrjeti i Njësive të Inteligjencës Financiare në Botë                     |
| EULEX     | Misioni i Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë             |
| FATF/TFVF | Task Forca e Veprimit Financiar  |
| FMN       | Fondi Monetar Ndërkombëtar   |
| FT        | Financimi i Terrorizmit  |
| goAML     | Sistemi elektronik i menaxhimit të dhënave                               |
| IFJB      | Institucionet Financiare Jobankare                                       |
| IGJK      | Instituti Gjyqësor i Kosovës   |
| ILECU     | Njësia për bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e zbatimit të ligjit       |
| IMF       | Institucion Mikrofinanciar   |
| IPA       | Instrumenti i Asistencës para Anëtarësimit (i Komisionit Evropian)       |
| KDK       | Kujdesi i Duhur ndaj Klientit  |
| KiE       | Këshilli i Evropës   |
| KKLKE     | Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik                     |
| KP        | Kodi Penal   |
| KPP       | Kodi i Procedurës Penale   |
| MF        | Ministria e Financave  |
| MM        | Marrëveshje e mirëkuptimit   |
| MONEYVAL  | Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave |
| NNJ       | Ndihma e Ndërsjellë Juridike   |
| OAK       | Oda e Avokatëve të Kosovës   |

|        |  |
|--------|--|
| OJQ    | Organizatë joqeveritare  |
| OKB    | Organizata e Kombeve të Bashkuara  |
| ONK    | Oda e Noterëve të Kosovës  |
| PECK   | Projekti i BE&KiE “Kundër Krimit Ekonomik në Kosovë”                     |
| PEP    | Personat e Ekspozuar Politikisht.  |
| PK     | Policia e Kosovës  |
| PP     | Pastrimi i parave  |
| PSO    | Procedura Standarde të Operimit  |
| PSRK   | Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës                              |
| QIF    | Qendra e Inteligjencës Financiare (paraardhësi i NJIF-it)                |
| RKSOKB | Rezolutë e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara |
| RTD    | Raporti i Transaksionit të Dyshimtë                                      |
| RTG    | Raporti i transaksionit në të gatshme (kesh)                             |
| SHKAÇK | Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Certifikuar të Kosovës        |
| TI     | Teknologjia Informative  |
| UNDP   | Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara                             |
| UNMIK  | Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë                                 |
| UNODC  | Zyra e Kombeve të Bashkuara kundër krimit dhe drogave                    |
| VKR    | Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut  |
| ZKK    | Zyra Kadastrale Komunale   |

## 1. HYRJA

Në përputhje me detyrimin ligjor të përcaktuar në nenin 10 të Ligjit Nr. 05/L -096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, më lejoni të prezantoj përpara jush raportin vjetor të aktivitetit të NJIF-K gjatë vitit 2019.

Në periudhën raportuese, aspektet kryesore në punën e Njesisë për Inteligjencë Financiare janë përqendruar kryesisht në përmirësimin e pozicionit dhe rolit të saj në parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit duke shërbyer si qendër e pavarur kombëtare në analizimin dhe shpërndarjen e informacionit në institucionet e zbatimit të ligjit, harmonizimin e legjislacionit kombëtar me standardet ndërkombëtare, ngritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe vlerësimin e rrezikut kombëtar në fushën e PPP/LFT.

Vlerësimi i rrezikut kombëtar ka gjetur se evazoni fiskal dhe korrupsioni gjenerojnë shumën më të madhe të të ardhurave. Evazoni fiskal në Kosovë është i lidhur fort me përhapjen e gjerë të informalitetit të ekonomisë, gjë që mundëson që fitimet të raportohen pjesërisht ose aspak.

Kosova është juridiksion që ballafaqohet me një sërë rreziqesh të brendshme dhe ndërkufitare të PP-së dhe FT-së, që përkeqësohen më tej nga faktorët strukturorë dhe rrethanorë në Kosovë. Një pjesë e madhe e ekonomisë joformale (pothuajse 32%) e përkeqëson rrezikun e shmangies nga tatimi, ndërsa përdorimi i përhapur i parave të gatshme kufizon më tej efektivitetin e çdo mekanizmi të kontrollit financiar, përfshirë PPP/LFT-në<sup>1</sup>.

NJIF-K mbetet e përkushtuar në forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit me çdo autoritet të përfshirë në luftën dhe parandalimin e PP/FT dhe krimeve financiare në përgjithësi, duke nxitur gjithashtu forcimin e partneritetit publiko-privat me qëllim sensibilizimin, ndërgjegjësimin dhe rritjen e reagimit ndaj këtyre fenomeneve negative që kanë pasoja në ambientin ekonomik, por edhe në sigurinë kombëtare në vend.

Qëllimi strategjik i NJIF-K është të sigurojë një regjim efikas për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit në Kosovë duke zhvilluar proceset e veta të brendshme dhe metodat e punës të orientuara kah performanca, korniza ligjore dhe bashkëpunimin me partnerët kombëtar dhe ndërkombëtar. FIU vazhdon të jetë një partner i rëndësishëm në zbatimin e masave të parashikuara nga samiti i Londrës dhe Procesit të Berlinit.

Gjatë vitit 2019, ndër zhvillimet e rëndësishme vlerësohet miratimi nga ana e Qeverisë Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023.

Përtej arritjeve pozitive të viteve të fundit, mbeten ende shumë sfida për tu adresuar, veçanërisht në rritjen e numrit të dënimeve dhe konfiskimeve finale për rastet e pastrimit të parave. Arritjet e deritanishme, por edhe sfidat që na presin kërkojnë një nivel shumë të lartë bashkëpunimi ndër-institucional e ndërkombëtar.

---

<sup>1</sup> Raporti i Vlerësimit të BE&KiE (PECK II)



## 2. ORGANIZIMI I NJIF KOSOVA

### 2.1. Buxheti dhe Prokurimi

#### 2.1.1. Buxheti

Një nga funksionet themelore të NJIF-ve që siguron pavarësinë dhe autonominë e saj dhe i lejojnë asaj të zhvillojë mandatin në mënyrë efektive është sigurimi i burimeve adekuatë financiare, njerëzore dhe teknike.

Gjithashtu për të ruajtur pavarësinë dhe autonominë operative të NjIF-ve, ato duhet të kenë lirinë të marrin dhe të vendosin në mënyrë të pavarur për shfrytëzimin e buxhetit të ndara në bazë të nevojave të tij operative, duke përfshirë angazhimin e saj në aktivitete ndërkombëtare. Burimet e saj (njerëzore, financiare dhe teknike) duhet të menaxhohen në mënyrë të veçantë, pasi kjo praktikë do të sigurojë pavarësinë operacionale të NJIF-ve. Po ashtu NjIF-ët do të duhej të jenë përgjegjës për menaxhimin e shëndoshë financiar dhe të raportojë mbi përdorimin e fondeve për palët e interesit.

Në nenin 4 të Ligjit për PPP/LFT përcakton përdorimin në mënyrë të pavarur të buxhetit të NJIF-K duke përkufizuar:

*"NJIF-K ka buxhetin e vet i cili sigurohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës, në pajtim me ligjin vjetor të buxhetit. NJIF-K vendosë në mënyrë të pavarur për shfrytëzim të buxhetit, në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë".*

Në përputhje me planifikimin e buxhetit të NJIF-K për vitin 2019, dhe me Ligjin Nr.06/L-133 për buxhetin e vitit 2019, Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës kanë përcaktuar shumat e lejuara dhe ka dhënë në dispozicion për shpenzim nga Buxheti i Kosovës për tërë sektorin publik përfshirë edhe NJIF-K, për të cilin është ndarë buxheti në shumë prej 460,528 Euro.

Zyra për Buxhet dhe Financa në NJIF-K, veprimtarinë e vetë e kryen bazuar në Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007, dhe ofron mbështetje profesionale në lëmine e planifikimit të buxhetit, Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, Planit të Rrjedhës së Parasë, Përgatit Pasqyrat Financiare Vjetore ne bashkëpunim me Ministrinë e Financave.

Buxheti i NJIF-K për vitin 2019 dhe procesi i realizimit të tij sikur edhe në vitet e mëparshme, në përputhje me objektivat dhe prioritet e përcaktuara të saj, ka përmbyllur me sukses buxhetin për vitin 2019.

Ndarja buxhetore fillestare sipas Ligjit të Buxhetit Ligjin Nr.06/L-133 për vitin 2019, ka qenë 460,528 Euro, kurse me rregullim të brendshëm të buxhetit nga Ministria e Financave, kjo shumë ka ndryshuar në shumën 467,762 Euro.

Bazuar në procesin e planifikuar të shpenzimit të buxhetit në të gjitha kategoritë ekonomike, gjatë tërë viti 2019 ka arritur shkallën e realizimit 85%. Mos-nënshkrimi i kontratës për sistemin

e IT (goAML) dhe vonesat e shkaktuara nga ana e krijuesit të sistemit kanë ndikuar në mos-realizimin sipas planifikimit të kategorisë së Mallrave dhe shërbimeve.

| Kategoritë Ekonomike | Buxheti 2019      | Buxheti        | Buxheti i shpenzuar |             |
|----------------------|-------------------|----------------|---------------------|-------------|
|                      | ndarja fillestare | pas rishikimit | realizimi           | Realizimi % |
|                      | 1                 | 2              | 3                   | 4           |
| Paga dhe mëditje     | 223,395           | 230,629        | 230,629             | 100%        |
| Mallra dhe shërbime  | 195,658           | 195,658        | 130,341             | 67%         |
| Shpenzimet komunale  | 11,475            | 11,475         | 7,637               | 67%         |
| Shpenzime kapitale   | 30,000            | 30,000         | 28,160              | 94%         |
| <b>Gjithsej</b>      | <b>460,528</b>    | <b>467,762</b> | <b>396,767</b>      | <b>85%</b>  |

Tabela 1: Tabela e ndarjeve dhe realizimit të buxhetit 2019

### 2.1.2. [Aktivitetet e Prokurimit](#)

Gjatë vitit 2019 sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 janë zhvilluar gjithsej tetë (8) aktivitete të prokurimit.

Sipas procedurës aktivitete të prokurimit janë të ndara në :

- Dy (2) aktivitete të prokurimit me procedurë të hapur,
- Katër (4) aktivitete kanë qenë me procedurën e kuotimit.
- Një (1) aktivitete të prokurimit me procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë.
- Një (1) aktivitete kanë qenë me procedurën e vlerës minimale.

Ndërsa sipas vlerës se planifikuar të prokurimit

- Dy (2) janë me vlerë të mesme.
- Katër (4) janë me vlerë të vogël dhe
- Një (1) janë me vlerë minimale

## 2.2. [Organizimi i NJIF-K](#)

### 2.2.1. [Mbikëqyrja e NJIF-K, burimet njerëzore dhe Struktura organizative e NJIF-K](#)

Struktura organizative e NJIF-K rregullohet përmes rregullores nr. 01/2018 për organizimin e brendshëm në Njësinë për Inteligjencë Financiare e cila përcakton strukturën organizative si dhe organizimin e brendshëm të Njësisë për Inteligjencë Financiare.



Struktura organizative të NJIF-K e përbëjnë: Bordi Mbikëqyrës i NJIF-K, Drejtori i NJIF-K si dhe Sektorët

Bordi Mbikëqyrës i NJIF-K përbëhet nga: Kryetari dhe anëtarët e Bordit Mbikëqyrës, si dhe Sekretari i Bordit Mbikëqyrës. Sekretari i Bordit është zyrtar i Ministrisë së Financave i cili caktohet nga Kryetari i Bordit të NJIF-K, bazuar në nenin 8 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit dhe shërben si Sekretar i Bordit.

Pavarësia dhe autonomia operative e Njësive të Inteligjencës Financiare është thelbësore për një regjim efektiv të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. NJIF-të luajnë rol qëndror duke siguruar informacion financiar dhe inteligjencë që mbështesin punën e autoriteteve të zbatimit të ligjit, autoriteteve tjera dhe homologëve të huaj. Mungesa e autonomisë ose pavarësisë operacionale dëmton jo vetëm efektivitetin e veprimtarive të NJIF-ve, por gjithashtu ka ndikim në hetimet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe ndjekjeve penale. Për këtë qëllim, Egmont Group ka nxjerrë një dokument "*Të kuptuarit e pavarësisë dhe autonomisë operacionale të NJIF-ve*<sup>2</sup>". Ky dokument është hartuar për të ndihmuar qeveritë (vendimmarrësit dhe hartuesit e politikave), NJIF-ët dhe akterët tjerë kryesorë në identifikimin dhe kuptimin e karakteristikave që përcaktojnë dhe forcojnë pavarësinë


Mbi bazën e këtij dokumenti NJIF-ëve duhet siguruar burime adekuate financiare, njerëzore dhe teknike, në një mënyrë që siguron dhe promovon autonominë dhe pavarësinë e saj dhe i lejon asaj të zhvillojë mandatin e tij në mënyrë efektive. Në përcaktimin nëse janë atribuar burime të mjaftueshme, duhet të bëhet vlerësimi nëse NJIF-ët kanë burimet e nevojshme financiare, njerëzore dhe teknike për të marrë dhe analizuar informacionin dhe shpërndarë inteligjencën financiare. Procesit dhe procedurat me të cilat NJIF siguron burimet duhet të përjashtojnë situatat që mund të çojnë në ndërhyrje dhe ndikim të padrejtë. Niveli i burimeve adekuate do të ndryshojë në varësi të kontekstit dhe mjedisit të rrezikut të secilit NJIF dhe trendit të raportimit të RTD-ve.

Duke njohur natyrën ndërkombëtare të punës që zhvillohet nga NJIF-ët, ato gjithashtu duhet të kenë autoritetin të vendosin se kur dhe ku do të udhëtojnë bazuar në nevojat e saj operative, duke përmbushur nevojat në lidhje me proceset strategjike dhe operacionale të NJIF-ëve, për të ndjekur trajnime, ose për të marrë pjesë në takime dhe forume ndërkombëtare për të forcuar marrëdhëniet me NJIF-ët e huaj dhe shkëmbimin e informacioneve mbi praktikatat më të mira dhe mësimet e marra të NJIF-ëve. Kuptohet, gjitha këto duhet të jenë brenda kornizës buxhetore të NJIF-it.

<sup>2</sup> Understanding FIU Operational Independence and Autonomy, Egmont Centre of FIU Excellence and Leadership (ECOFEL)


dhe autonominë operacionale të NJIF-ve.

Të punësuarit në NJIF-K janë 21 zyrtarë. Sektori i Operativës dhe Analizës mbulon rreth 33% të stafit, i ndjekur nga Sektori për Pajtueshmëri dhe Inspektim. NJIF-K është pjesë thelbësore e sistemit të luftimit të financimit të terrorizmit. Megjithatë, për t'u përballur efektivisht me këtë fenomen nevojitet ngritje e kapaciteteve të stafit dhe resurseve. Për të përmirësuar shkëmbimin e informatave dhe bashkëpunimin operacional në NJIF-K janë të angazhuar tre (3) zyrtar ndërlidhës nga institucionet vendore të zbatimit të ligjit, një nga Dogana e Kosovës, një nga Policia e Kosovës dhe një nga AKI.



Grafiku 1: Burimet njerëzore të NJIF-K

Struktura organizative e NJIF-K është si vijon:



### 3. ZHVILLIMET LIGJORE PËR PPP/LFT

Përgjatë vitit 2019, fokusi kryesor i Njesisë për Inteligjencë Financiare në fushën e legjislacionit ishte i përqendruar në realizimin e planit legjislativ dhe planit të performancës dhe resurseve të NjIF-K, ofrimi i opinioneve ligjore sipas kërkesave të adresuara, përmes të cilave sigurohet përmbushja e detyrave ligjore në zbatimin e ligjit dhe të dispozitave tjera nga fushë veprimtaria e NjIF-K, si synim drejt arritjes së objektivave me qëllim të parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit.

Me datë 23/01/2019 me ref. Nr. 11-2019 nga Ministria e Financave është themeluar Grupi Punues për Hartimin e Koncept Dokumentit për Trajtimin e legjislacionit të Pastrimit të Parave, me qëllim të përafrimit të tij të mëtutjeshëm me Rekomandimet e Task Forcës së Veprimit Financiar dhe me acquis communautaire të BE-së. Ky grup punues ka një përbërje të gjerë të anëtarëve nga institucionet relevante dhe anëtarët e jashtëm të cilët janë hisedarë në zbatimin e Ligjit për PPP/LFT. Tutje, si parakusht për fillimin e punës së hartimit të koncept dokumentit ka qenë edhe mbajtja e trajnimit për anëtarët e grupit punues i cili është organizuar nga Sekretariati Koordinues i Qeverisë me qëllim të familjarizimit rreth metodologjisë së re të punës bazuar në Udhëzuesin dhe Doracakun për Hartimin e Koncept Dokumenteve. Tutje Grupi Punues ka vazhduar aktivitetet e punës me qëllim të finalizimit të këtij procesi.

Sa i përket fushës së legjislacionit një rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe hartimit të Projekt Ligjit për Zbatimin e Sanksioneve Financiare Ndërkombëtare të Shënjestruara ku bartës i këtij procesi është Ministria e Punëve të Jashtme, ndërsa dy anëtarë të këtij grupi janë nga NjIF-K. Duke pasur në konsideratë faktin se gjatë vlerësimit të përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare të PPP/LFT të realizuar nga Projekti Kundër Krimin Ekonomik në Kosovë është rekomanduar të miratohet sa më parë legjislacioni që parasheh masa për ekzekutimin e sanksioneve financiare të shënjestruara lidhur me Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB) përkatëse, grupi punues me qëllim të adresimit të këtij rekomandimi ka finalizuar hartimin e Projekt Ligjit në fjalë i cili pritet të miratohet nga Qeveria.


Gjithashtu, për të përmbushur objektivat që dalin nga Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, është punuar në hartimin e Projekt Udhëzimit Administrativ për Pronësinë Përfituese me qëllim të fuqizimit të aftësisë së autoriteteve kompetente dhe subjekteve raportuese për identifikim të pronësisë përfituese dhe përmirësimit të transparencës ndaj pronarëve të vërtetë të kompanive dhe marrëveshjeve ligjore. Ky proces zhvillohet në mënyrë që të parandalohet dhe kufizohet keqpërdorimi i personave juridikë dhe marrëveshjeve juridike për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit përmes strukturave të errëta dhe komplekse. Mbështetur në ekspertizë e ofruar nga Projekti i BE/Këshillit të Evropës kundër Krimin Ekonomik (PECK II) në fushën e PPP/LFT me datë 07 Maj 2019 është mbajtur një punëtori ku është prezantuar dokument teknik që përmban Rekomandimet për Transparencën e Pronësisë Përfituese si Përgjigje ndaj Raportit të Vlerësimit për Kosovën dhe pas publikimit të këtij dokumenti nga Projekti, me datë 12/07/2019 është nxjerr vendim për caktimin e ekipit përgjegjës për hartimin e Udhëzimit për Pronësinë Përfituese, ekip i cili ka mbajtur disa takime dhe është duke punuar për hartimin e këtij projekt udhëzimi.



Gjatë vitit 2019 po ashtu është punuar edhe në hartimin e akteve nënligjore si në vijim:

- Procedurës Standarde të Operimit për Procesin e Inteligjencës bazuar në goAML,
- Procedurës Standarde të Operimit për Shpërndarjen e Inteligjencës;
- Procedurës Standarde të Operimit për Ngrirjen e Transaksionit
- Udhëzim Administrativ për Subjektet Raportuese për Raportimin e RAD-ve
- Udhëzuesin për Qasjen dhe Mbikëqyrjen e Bazuar në Rrezik;
- Udhëzues për faktorët e rrezikut për subjektet raportuese
- Kodin e Etikës për zyrtarët e NJIF-K

NjIF-K është angazhuar edhe në arritjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione vendore dhe ato ndërkombëtare, me qëllim të kryerjes me efikasitet të detyrave lidhur me çështjet brenda fushave të kompetencave reciproke të institucioneve përkatëse. Në pajtim me autorizimet ligjore dhe objektivat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, NjIF-K vazhdon me zhvillimin e mëtutjeshëm të një kornize ligjore moderne në pajtim me Rekomandimet e Task Forcës së Veprimit Financiar dhe me *acquis communautaire* të BE-së me qëllimin kryesor parandalimin e pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimin e terrorizmit.




## 4. ANALIZA DHE INTELIGJENCA

### 4.1.1. Të dhënat dhe raportet e proceduara

NJIF-K është institucioni kryesor kombëtar për mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit në lidhje me PP dhe FT dhe bashkëpunon me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit në hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve financiare. NJIF-K pranon raporte si nga institucionet financiare ashtu edhe nga ato jo-financiare që krijojnë dyshim të arsyeshëm se pasuria e përfshirë në aktin apo transaksionin, ose në aktin ose transaksionin e tentuar, është produkt i krimit apo ndërlidhet me financimin e terrorizmit. NJIF-K gjithashtu pranon raporte nga institucione të tjera mbikëqyrëse dhe zbatuese të ligjit, brenda dhe jashtë vendit gjatë veprimtarisë së tij.

Gjithsej 10,047 raporte janë proceduar në sistemin elektronik të përpunimit të të dhënave.



Grafiku 2: Dinamika e raporteve të proceduara në 2016-2019

Informacioni dhe raportet e pranuar, rishikohen dhe analizohen lidhur me trendët, modelet dhe lidhjet e tjera që mund të tregojnë nëse janë të lidhura me PP/FT. Pas kësaj analize, NJIF-K përcakton veprimet që duhen ndërmarrë, përfshirë nëse do të ndërmarrë analiza shtesë. Kur është e përshtatshme, NJIF-K gjithashtu mund të ndajnë rezultatet e këtyre analizave me autoritetet përkatëse të zbatimit të ligjit vendor dhe NJIF të huaj.

| Numri i të dhënave dhe raporteve të proceduara |       |       |       |       |
|--|-------|-------|-------|-------|
| Lloji i Raportit                               | 2016  | 2017  | 2018  | 2019  |
| AIF  | 6,325 | 3,718 | 3,222 | 3,337 |
| CTR  | 2,396 | 2,177 | 2,464 | 2,633 |
| FDR  |       | 68    | 19    | 16    |
| FRZ  | 85    | 3     | 4     | 3     |



|           |        |       |       |        |
|-----------|--------|-------|-------|--------|
| INR       | 17     | 17    | 14    | 25     |
| IRD       | 113    | 125   | 156   | 175    |
| IRI       | 16     | 33    | 32    | 26     |
| ORD       | 1,628  | 1008  | 2033  | 2754   |
| ORI       | 13     | 35    | 62    | 74     |
| STR (PP)  | 480    | 704   | 639   | 997    |
| TFR       | 5      | 7     | 5     | 7      |
| UTR       | 23     | 52    | 143   | 0      |
| Gjithsej: | 11,101 | 7,947 | 8,793 | 10,047 |

Tabela 2: Numri i raporteve të proceduara përmes sistemit elektronik dhe online 2016-2019

#### 4.1.2. [Raportimi i Transaksioneve/Aktiviteve të Dyshimta \(RTD/RAD\)](#)

RTD/RAD është pjesë e informacionit që paralajmëron autoritetet kompetente se një aktivitet apo transaksion i caktuar për klientin, personin ose subjektin, në një farë mënyre është i dyshimtë dhe mund të shfaq dyshime për pastrim të parave ose financim të terrorizmit.


Subjekteteve raportuese u kërkohet sipas nenit 26 të Ligjit 05/L-096 për PPP/LFT të dorëzojnë një RTD/RAD në lidhje me informacionet që u vijnë atyre gjatë veprimtarisë së tyre, nëse kanë njohuri, dyshojnë ose kanë arsye të arsyeshme për të ditur ose dyshuar, që një akt ose transaksion ose një akt ose transaksion i tentuar, që krijon dyshim të arsyeshëm se pasuria e përfshirë në aktin apo transaksionin, ose në aktin ose transaksionin e tentuar, është produkt i krimit apo ndërlidhet me financimin e terrorizmit.

Sidoqoftë, edhe nëse personi/at nuk janë të listuar si subjekte raportuese, mund të paraqesin RAD në mënyrë vullnetare, por sipas legjislacionit në fuqi janë edhe të detyruar të lajmrojnë organet kompetente nëse kanë "njohuri" ose "dyshim" ose nëse dijnë ose kanë arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal. Në të kundërtën, mos lajmrimi i aktiviteteve të paligjshme mund të konsumoj veprën penale dhe të ndihmoj të tjerët për të kryer, nxitur apo lehtësuar pastrimin e parave, financimin e terrorizmit apo veprave të ndërlidhura.

Raportimi i RTD-ve/RAD-ve ka për qëllim parandalimin dhe luftimin e PP/FT si dhe mbrojtjen e stabilitetit financiar dhe shoqërisë në përgjithësi nga rreziku i pastrimit të të ardhurave nga krimi dhe financimi i terrorizmit.



RTD-ve të pranuar gjatë vitit 2019 paraqesin një rritje prej 59% krahasuar me 644 raporte të tilla të pranuar në një vit më parë. Gjatë periudhës pesë-vjeçare, raportimi nga institucionet financiare ka shënuar ngritje të qëndrueshme, ndërsa raportimet nga Noteret janë rritur nga 2 (periudha 2015-2017) në 37 në vitin 2018 respektivisht 76 në 2019.



Grafiku 3: Numri i RTD-ve të raportuara 2011-2019


Bankat dhe Agjencionet e transferit të parave janë një burim i rëndësishëm në rritje të RTD-ve në krahasim me sektorin e BPCJF-ve. Midis viteve 2018 dhe 2019, numri i RTD-ve nga bankat u rrit nga 599 në 785 (apo 40%), ndërsa rritja më e ndjeshme (me 315%) është shënuar tek Agjencionet e Transferim

të Parave nga 33 në 137. Raportimet nga institucionet mikrofinanciare u rritën 70% nga 10 në 17. Noterët, si nëngrup i BPCJF-ve, kanë paraqitur 76 RTD gjatë vitit 2019, që përbën edhe numrin më të madh të raportimeve të dorëzuara ndonjëherë nga ky sektor.



Grafiku .4: Numri i RTD-ve të raportuara sipas sektorëve 2019

Vlerësimi i informacionit që arrin në NJIF-K, përveç dyshimit të ngritur nga subjekti raportues, informacionit të tillë gjithashtu i shtohet vlerë dhe merren parasysh edhe informacione të tjera nga bazat e të dhënave ose përfshirë informacion e mbledhur nga burime të tjera. Ky informacion nuk është i kufizuar në transaksionin ose aktivitetin në fjalë, por synon të njohë personat ose subjektet e përfshira. Po ashtu gama e zgjerimit të periudhës kohore të përfshirë në analiza shkon përtej periudhës së paraqitur në raportin e transaksionit të dyshimtë.



| Numri i RTD-ve të raportuara sipas sektorëve 2015-2019  |            |            |            |            |             |                    |
|---|------------|------------|------------|------------|-------------|--------------------|
| Subjektet Raportuese  | 2015       | 2016       | 2017       | 2018       | 2019        | Gjithsej 2015-2018 |
| <b>Bankat dhe Institucionet Financiare</b>  |            |            |            |            |             |                    |
| Bankat  | 350        | 438        | 683        | 559        | 785         | 2815               |
| Institucionet Mikrofinanciare   | 2          | 6          | 5          | 10         | 17          | 40                 |
| Sektori i sigurimeve  | -          | -          | -          | 2          | 5           | 7                  |
| Këmbimoret (Këmbimi i parave dhe monedhave)   | -          | -          | -          | -          | -           | 0                  |
| Agjencionet për Transfer Parash   | 39         | 34         | 34         | 33         | 137         | 277                |
| Leasing   | -          | -          | -          | -          | 3           | 3                  |
| Sektori i letrave me vlerë  | -          | -          | -          | -          | -           | 0                  |
| Institucionet tjera Financiare  | -          | -          | -          | -          | -           | 0                  |
| <b>BPCJF-të</b>   |            |            |            |            |             |                    |
| Kazinetë dhe Lojërat e fatit  | -          | -          | -          | -          | -           | 0                  |
| Agjentët e pasurive të patundshme dhe ndërmjetësit e pasurive të patundshme   | -          | -          | -          | -          | -           | 0                  |
| Avokatët  | -          | -          | -          | 2          | 1           | 3                  |
| Noterët   | -          | 2          | -          | 37         | 76          | 115                |
| Kontabilistët e certifikuar dhe këshilltarët tatimor  | -          | -          | -          | -          | 1           | 1                  |
| Auditorët e licencuar   | -          | -          | -          | -          | -           | 0                  |
| Trustet dhe ofruesit e shërbimeve për kompanitë   | -          | -          | -          | -          | -           | 0                  |
| Organizatrat Jo-Qeveritare  | -          | -          | -          | -          | -           | 0                  |
| Shitësit e metaleve të çmuara dhe tregtarët me gurë të çmuar  | -          | -          | -          | -          | -           | 0                  |
| Personat fizikë dhe juridikë që tregtojnë mallra kur pranojnë pagesa në para të gatshme në vlerë prej dhjetëmijë (10.000) euro ose më shumë (Përfshirë Auto-Sallonet) | -          | -          | -          | -          | -           | 0                  |
| Profesionistë të tjerë  | -          | -          | -          | -          | -           | 0                  |
| <b>Mbikëqyrësit dhe institucionet tjera</b>   |            |            |            |            |             |                    |
| Dogana e Kosovës  | 4          | 1          | -          | 1          | -           | 6                  |
| Mbikëqyrësit sektorial  | 2          | 2          | 4          | -          | 1           | 9                  |
| Tjera   | 1          | 2          | 2          | -          | 1           | 6                  |
| <b>Gjithsej RTD-të e raportuar 2015-2019</b>  | <b>398</b> | <b>485</b> | <b>728</b> | <b>644</b> | <b>1027</b> | <b>3282</b>        |


Tabela 3: Numri i RTD-ve të raportuara sipas sektorëve 2015-2019



Zhvillimet e viteve të fundit kanë ngritur gatishmërinë e komunitetit ndërkombëtare dhe janë bashkuar në fushatën për të ngrirë fondet ose pasuritë e tjera të terroristëve dhe atyre që financojnë terrorizmin apo organizatat terroriste. Rezolutat e Kombeve të Bashkuara kanë përcaktuar disa nga detyrimet kryesore për vendet si: të parandalojnë dhe ndëshkojnë financimin e akteve terroriste; të dënojnë sigurimin ose mbledhjen e fondeve nga shtetasit e tyre apo në territorin e tyre për kryerjen e akteve terroriste; të sigurojnë ngrirjen pa vonesë të fondeve dhe pasurive të tjera financiare të personave që kryejnë ose sigurojnë mbështetje në kryerjen e akteve terroriste; gjithashtu ju ndalon të gjithë personave fizikë dhe juridikë të një vendi, të japin çfarëdo shërbimesh financiare apo ndonjë formë tjetër mbështetje për personat e shpallur; të parandalojnë nëpërmjet kontrolleve efektive të kufirit, lëvizjen e terroristëve ose grupeve terroriste; të përshpejtojnë dhe intensifikojnë shkëmbimin e informacionit për çështjet e financimit të terrorizmit.

Padyshim që Njësitë e Inteligjencës dhe organet ligj-zbatuese gjenden përballë nevojës së marrjes të masave të duhura për një reagim të shpejtë dhe efikas. Nisur nga kjo, NJIF-K në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ) kanë hartuar Projektligjin për zbatimin e sanksioneve financiare ndërkombëtare të shënjestruara për të cilin kanë përfunduar konsultimet publike.

Megjithatë, NJIF-K që në vitin 2015 ka lëshuar një Urdhëresë Administrative për parandalimin dhe zbulimin e financimit të terrorizmit e cila zbatohet nga të detyruarit e ligjit. Mbështetur në indikatorët që përmban ky akt nënligjor, NJIF-K në vazhdimësi ka pranuar raporte të aktiviteteve të dyshimta për financim të terrorizmit.



Grafiku 5 : RTD të raportuara për FT 2013-2019

| Informacionet statistikore sipas sektorëve mbi raportet e dyshimta (RTD) të raportuara për Financim të Terrorizmit 2013-2019 |      |      |      |      |      |      |      |
|--|------|------|------|------|------|------|------|
| Subjekti raportues   | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 |
| Bankat Komerciale  | 6    | 15   | 23   | 19   | 10   | 11   | 4    |
| Institucionet Mikrofinanciare  | -    | -    | -    | -    | -    | -    | -    |
| Agjencionet për Transfer Parash  | -    | 1    | 3    | 15   | 8    | 4    | 6    |
| Këmbimoret (Shkëmbimi i valutave)  | -    | -    | -    | -    | -    | -    | -    |
| BPPJF-të   | -    | -    | -    | -    | -    | -    | -    |
| Mbikëqyrësit sektorial   | -    | -    | -    | 1    | -    | -    | -    |
| Dogana e Kosovës   | 1    | -    | -    | -    | -    | -    | -    |
| Tjera  | -    | -    | -    | 1    | -    | -    | 1    |
| Gjithsej RTD-të për FT   | 7    | 16   | 26   | 36   | 18   | 15   | 11   |

Tabela 4: Informacionet për raportet e dyshimta (RTD) për FT të pranuar nga NJIF-K 2013-2019

#### 4.1.2.1. *Indikatorët e Përgjithshëm dhe specifikë për PPP/LFT*

Indikatorët e pastrimit potencial të parave të shënuar më poshtë synojnë ngritjen dhe vetëdijesimin e subjekteve raportuese në pajtim me PPP/LFT. Këta indikatorë në vijim nuk nënkuptohet se janë të vetmit por vetëm ofrojnë shembuj për mënyrat më bazike se si mund të bëhet pastrimi i parave.

| Indikatorët e PP/FT  | Nr_i indikatorëve në RTD/RAD |
|--|------------------------------|
| Aktiviteti i llogarisë është jo-konsistent me profilin e klientit;   | 311                          |
| Qarkullim i lartë në llogarinë që përfshin shuma të konsiderueshme të fondeve në para në të gatshme;   | 201                          |
| Transaksione të ngjashme të kryera përgjatë një periudhe të shkurtë kohore;  | 191                          |
| Evazion Fiskal / Kontrabande / Krimet e taksave  | 145                          |
| Blerja e aseteve në vlerë të lartë (p.sh. patundshmëri, vetura luksoze);   | 130                          |
| Depozitimi apo tërheqja e instrumenteve të shumëfishta monetare në shumat të cilat në të vazhdueshme janë shumë afër nën-pragun identifikues apo raportues;  | 123                          |
| Depozitime të rregullta të shumëfishta në para në të gatshme të cilat duket se janë të ndërlidhura dhe nën pragun raportues prej 10,000 Euro të transaksionit të parave në të gatshme;   | 107                          |
| Strukturimi i fondeve përmes transfereve apo transaksioneve;   | 74                           |
| Transaksioni nuk ka ndonjë qëllim racional (të qartë dhe relevant) ekonomik apo biznesor;  | 39                           |
| Blerja e aseteve në vlerë të lartë (p.sh. patundshmëri, vetura luksoze);   | 27                           |
| Depozitimi apo tërheqja e parave në të gatshme në shuma të cilat në mënyrë të vazhdueshme janë shumë afër nën-pragun identifikues apo raportues;   | 24                           |
| Depozitimet në para në të gatshme në vlera të larta për të paguar transferet ndërkombëtare të fondeve;   | 21                           |
| Transferet e shumëfishta të fondeve të cilat duket se kanë lidhje me përfituesit e përbashkët;   | 21                           |
| Transaksioni nuk është ekonomikisht i arsyeshëm, duke pasur parasysh biznesin dhe profesionin e bartësit të llogarisë;   | 19                           |
| Mashtrim-et dhe Përdorimi i dokumenteve false;   | 18                           |
| Llogari biznesi përmes të cilave bëhet numër i madh i transfereve hyrëse dhe dalje elektronike dhe për të cilat duket se nuk ka ndonjë biznes logjik apo qëllim ekonomik, veçanërisht kur ky aktivitet është në, përmes apo nga vendet të cilat ngritin shqetësime | 18                           |
| Transferet e shumëfishta të fondeve në vlera të ulëta të cilat duket se janë të ndërlidhura;   | 17                           |
| Depozitime të mëdha në para në të gatshme të bëra në llogarinë individuale apo të personit juridik ku normalisht aktiviteti i biznesit të individit apo personit juridik mund të bëhet në metoda tjera të pagesës;   | 16                           |
| Klienti refuzon të ofroj informata të kërkuara nga institucioni financiar gjatë hapjes së llogarisë, tenton që të zvogëlojë nivelin e informatave të ofruara në minimum apo ofron informata ç'orientuese apo që vështirë verifikohen;                              | 12                           |
| Korrupsioni dhe përfshirja e PEP-ve vendor dhe ndërkombëtar  | 12                           |
| Identifikimi, masat e KDK dhe llogaria e përfituesit nuk është identifikuar si duhet;  | 12                           |
| Llogaritë që pranojnë depozitime relevante periodike e të cilat pasivizohen gjatë periudhave tjera;  | 12                           |
| Transferet dalje korrespondojnë të jenë transfere hyrëse të fondeve që duken të jetë transaksion 'kthyes';   | 11                           |
| Raportimet e pafavorshme në media lokale dhe bazat e të dhënave tregtare dhe ndërkombëtare   | 11                           |
| Transferet e shumëfishta të fondeve të cilat duket se kanë lidhje dhe bëhen nga i njëjti lokacion;   | 11                           |
| Transaksionet e shumëfishta të cilat duket se janë të lidhura, që ndodhin në të njëjtën ditë tek i njëjtit përfitues;  | 10                           |
| Përdorimi i llogarive të huaja të anëtarëve të familjes, të emëruarve etj;   | 9                            |
| Transaksionet dhe kompanitë e përfshira janë nga shtetet apo juridiksionet jo-bashkëpunuese të përcaktuara nga FATF si dhe transferet ndërkombëtare të fondeve të dërguara në juridiksionet që paraqesin rrezik të lartë;  | 8                            |


Tabela 5: Indikatorët e PP/FT

#### 4.1.2.2. Raportimi i Transaksioneve në para të gatshme (RTG)

Raportimi i transaksioneve në para të gatshme, e cila rrjedhë si obligim i subjekteve raportuese të ligjit për PPP/LFT, I është kushtuar vëmendje të vazhdueshme nga NJIF-K. Këto raportime kanë qenë një burim i rëndësishëm për veprimtarinë e analizave të NJIF-K.

Nga Qershori i vitit 2019, është zgjeruar gama e raportimit të RTG-ve edhe në sektorin e Auto Salloneve, kjo mbështetur në nënparagrafin 1.5 të nenit 16 të Ligjit 05/L-096 ku kërkohet që "personat fizikë dhe juridikë që tregtojnë mallra kur pranojnë pagesa në para të gatshme në vlerë prej dhjetëmijë (10.000) euro ose më shumë" të përcaktohen si subjekte raportuese dhe të zbatojnë gjitha obligimet që dalin nga ligji respektiv.

Në grafikun nr. 6 paraqiten të dhënat e raportimeve të transaksioneve në para të gatshme për periudhën 2013 – 2019.



Grafiku 6: Numri i RTG-ve të pranuar 2013-2019

| Raportet në lidhje me transaksionet mbi pragun e raportimit (RTG) të pranuar 2015-2019 |                              |                        |                              |                        |                              |                        |                              |                        |                              |                        |
|--|------------------------------|------------------------|------------------------------|------------------------|------------------------------|------------------------|------------------------------|------------------------|------------------------------|------------------------|
| Vitet  | Viti 2015                    |                        | Viti 2016                    |                        | Viti 2017                    |                        | Viti 2018                    |                        | Viti 2019                    |                        |
| Subjekti raportues   | Numri i Raporteve të pranuar | Numri i Transaksioneve | Numri i Raporteve të pranuar | Numri i Transaksioneve | Numri i Raporteve të pranuar | Numri i Transaksioneve | Numri i Raporteve të pranuar | Numri i Transaksioneve | Numri i Raporteve të pranuar | Numri i Transaksioneve |
| <b>Bankat dhe Institucionet Financiare</b>   |                              |                        |                              |                        |                              |                        |                              |                        |                              |                        |
| Bankat   | 2,028                        | 614,162                | 2,087                        | 774,463                | 1,992                        | 835,781                | 2,110                        | 959,350                | 2,240                        | 965,733                |
| IFJB-të  | 12                           | 25                     | 22                           | 184                    | 16                           | 384                    | 50                           | 923                    | 42                           | 1,489                  |
| Këmbimoret (Shkëmbimi i valutave)  | 292                          | 1875                   | 297                          | 2384                   | 264                          | 2122                   | 288                          | 2510                   | 323                          | 3288                   |
| Agjencionet për Transfer Parash  | 23                           | 104                    | 18                           | 99                     | 5                            | 213                    | 87                           | 205                    | 16                           | 34                     |
| <b>Gjithsej Bankat dhe Institucionet Financiare</b>                                    | <b>2,355</b>                 | <b>616,166</b>         | <b>2,424</b>                 | <b>777,130</b>         | <b>2,277</b>                 | <b>838,500</b>         | <b>2,535</b>                 | <b>962,988</b>         | <b>2,621</b>                 | <b>970,544</b>         |
| <b>BPPJF-të dhe Entitetet tjera raportuese</b>   |                              |                        |                              |                        |                              |                        |                              |                        |                              |                        |
| Auto Sallonet  | -                            | -                      | -                            | -                      | -                            | -                      | -                            | -                      | 16                           | 185                    |
| Dogana e Kosovës   | 12                           | 1264                   | 12                           | 1156                   | 12                           | 1108                   | 12                           | 1212                   | 12                           | 969                    |
| <b>Gjithsej ENTITETET TJERA RAPORTUESE</b>   | <b>12</b>                    | <b>1264</b>            | <b>12</b>                    | <b>1156</b>            | <b>12</b>                    | <b>1108</b>            | <b>12</b>                    | <b>1212</b>            | <b>12</b>                    | <b>1154</b>            |
| <b>Gjithsej RTG-të e pranuar</b>   | <b>2,367</b>                 | <b>617,430</b>         | <b>2,436</b>                 | <b>778,286</b>         | <b>2,289</b>                 | <b>839,608</b>         | <b>2,547</b>                 | <b>964,200</b>         | <b>2,633</b>                 | <b>971,698</b>         |

Tabela 6: Raportet në lidhje me transaksionet mbi pragun e raportimit (RTG) sipas sektorëve '15-'19

#### 4.1.3. Raportimi i Deklarimit Kufitar (Qarkullimi i mjeteve monetare brenda dhe jashtë Kosovës)

Kosova ka vite që ka adoptuar një sistem deklarimi të mjeteve monetare dhe instrumenteve monetare si për transportin ndërkuftar në hyrje ashtu edhe për ato në dalje (neni 33 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit për PPP / LFT). Dispozitat e lartpërmendura të Ligjit për PPP/LFT-në kërkojnë deklaratë me shkrim për instrumentet monetare dhe burimin e tyre të verifikueshëm kur shuma është 10.000 euro ose më shumë ose vlera e barasvlershme tyre në valutë të huaj dhe detyrimi nuk konsiderohet i përmbushur nëse informacioni është i pasaktë apo i paplotë.

Po ashtu Kosova ka krijuar një mekanizëm të institucionalizuar për bashkëpunimin e të gjitha autoriteteve përkatëse përmes Ligjit për Bashkëpunim ndërmjet Agjencive nr. 04/L-216. Ky akt juridik paraqet themelet e sistemit të Menaxhimit të Integruar të Kufirit që përfshin të gjitha autoritetet kompetente të drejtpërdrejta për menaxhimin e kufirit dhe siguron mekanizma për analizën e rrezikut e kërcënimeve dhe inteligjencën e përbashkët, operacionet e përbashkëta, hetimet e përbashkëta, ndihmën teknike dhe profesionale, arsimin dhe trajnimin.

Ky bashkëpunim bazohet gjithashtu në një marrëveshje mirëkuptimi të nënshkruar në vitin 2014, si dhe në procedurat standarde zyrtare të operimit.

Dogana e Kosovës merr të gjitha masat e duhura për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe raportojnë tek NJIF-K për çdo akt dhe transaksion të dyshimtë lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit që zbulon gjatë kryerjes së detyrave të saj. Dogana e Kosovës mban lidhje me NJIF-K, prokurorët, policinë dhe organet tjera përkatëse për qëllimin e kryerjes së këtyre detyrave.

Të dhënat për vitin 2019 tregojnë një rënie prej 20% të numrit të deklarimeve në pikë kalimet kufitare krahasuar me vitin paraprak.

*Personat që nuk përmbushin detyrimin sipas paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 33 të Ligjit për PPP/LFT-në i nënshtrohen sanksionit financiar (gjobë për kundëroajtje) në pajtim me nenin 33, paragrafi 5 që përbën 25% të shumës së përgjithshme që duhet të deklarohet. Kjo gjithashtu do të zbatohet në rastin e një deklarate të paplotë ose të pasaktë, përfshirë gjithashtu burimin e verifikueshëm të instrumenteve monetare. Ky sanksion nuk paragjykon procedurat penale kundër personit që kryen shkeljen. Ndëshkimi financiar është menjëherë i pagueshëm ose përndryshe instrumentet monetare mund të jenë subjekt i sekuestrimit. Sekuestrimi zbatohet gjithashtu në rastin e dyshimit, deklarimit të pasaktë ose të paplotë sipas paragrafit 15.2 të të njëjtit nen ku vijimi i procedurës është i lidhur me vendimet e prokurorisë sipas paragrafit 19.*

*Ky sanksion nuk paragjykon procedurat penale kundër personit që kryen shkeljen.*



| Deklarimi i mjeteve monetare në pikat kufitare |                  |                |                              |
|--|------------------|----------------|------------------------------|
| Numri i Raporteve të deklaruara                |                  |                |                              |
| Vitet  | Personat Juridik | Personat Fizik | Numri i deklarimit te RTG-ve |
| 1  | 2                | 3              | 4 = (2+3)                    |
| 2019   | 650              | 319            | 969                          |
| 2018   | 816              | 396            | 1,212                        |
| 2017   | 664              | 444            | 1,108                        |
| 2016   | 732              | 424            | 1,156                        |
| 2015   | 606              | 658            | 1,264                        |
| 2014   | 667              | 583            | 1,250                        |
| <b>Gjithsej</b>                                | <b>4,135</b>     | <b>2,824</b>   | <b>6,959</b>                 |

Tabela 7: Deklarimi i mjeteve monetare në pikat kufitare 2014-2019


Deklarimi i mjeteve monetare në valutat kryesore tregon që Euro përbën valutën kryesore të deklarimit të mjeteve monetare, ndjekur pastaj nga frangu zviceran, dollari amerikan dhe paundi britanik.

| Transporti ndërkufitar i monedhës dhe instrumentet e negociueshme të mbajtësit |                         |                     |                                     |
|--|-------------------------|---------------------|-------------------------------------|
| Valuta   | Vlera monetare e RTG-ve |                     | Vlera totale e deklarimit te RTG-ve |
|  | Deklarimet ne Hyrje     | Deklarimet ne Dalje |                                     |
| 1  | 2                       | 3                   | 4 = (2+3)                           |
| ALL  | 3,733,000.00            | -                   | 3,733,000.00                        |
| AUD  | -                       | 171,740.00          | 171,740.00                          |
| CAD  | -                       | 508,485.00          | 508,485.00                          |
| CHF  | 4,035,742.00            | 243,630,050.00      | 247,665,792.00                      |
| DKK  | 221,000.00              | 4,455,600.00        | 4,676,600.00                        |
| EUR  | 81,793,234.65           | 577,634,275.00      | 659,427,509.65                      |
| GBP  | 40,000.00               | 12,590,000.00       | 12,630,000.00                       |
| HRK  |                         | 386,725.00          | 386,725.00                          |
| NOK  | 750,400.00              | 8,852,850.00        | 9,603,250.00                        |
| RSD  | 14,819,413,000.00       | -                   | 14,819,413,000.00                   |
| SEK  | 889,000.00              | 11,675,750.00       | 12,564,750.00                       |
| USD  | 6,811,354.00            | 17,105,170.00       | 23,916,524.00                       |

Tabela 8: Deklarimi i mjeteve monetare brenda dhe jashtë Kosovës 2019








Grafiku 7: Deklarimi bazuar në valutat kryesore 2019

Bankat Komerçiale në vend përbëjnë volumin më të lartë të deklarimit të mjeteve monetare, të cilat kryesisht janë deklarime në dalje (rreth 95%). Përderisa personat fizikë dhe subjektet juridike mbartin në vete një volum shumë më të ulët të deklarimit të mjeteve monetare.



Grafiku 8: Deklarimi sipas llojit të bizneseve 2019



**Deklarimi i mjeteve monetare (valutat kryesore) në pikat kufitare Deklarimet sipas llojit të bizneseve 2019**


| Lloji i bizneseve                | Gjithsej Deklarimet | Numri i Raporteve të deklaruara |                     | USD                  |               | Euro                  |                | GBP                  |               | CHF                   |                |
|----------------------------------|---------------------|---------------------------------|---------------------|----------------------|---------------|-----------------------|----------------|----------------------|---------------|-----------------------|----------------|
|                                  |                     | Deklarimet ne Hyrje             | Deklarimet ne Dalje | Ne hyrje             | Ne dalje      | Ne hyrje              | Ne dalje       | Ne hyrje             | Ne dalje      | Ne hyrje              | Ne dalje       |
| <b>Bankat Komercale + BQK</b>    | 291                 | 133                             | 158                 | 6,525,000            | 16,934,600    | 75,621,350            | 542,940,000    |                      | 12,590,000    | 45,000                | 243,077,000    |
| <b>Personat Fizik + Bizneset</b> | 677                 | 255                             | 423                 | 286,354              | 170,570       | 6,171,885             | 34,694,275     | 40,000               |               | 3,990,742             | 553,050        |
| <b>Gjithsej</b>                  | 968                 | 388                             | 581                 | 6,811,354.00         | 17,105,170.00 | 81,793,234.65         | 577,634,275.00 | 40,000.00            | 12,590,000.00 | 4,035,742.00          | 243,630,050.00 |
| <b>Totali i përgjithshëm</b>     |                     |                                 |                     | <b>23,916,524.00</b> |               | <b>659,427,509.65</b> |                | <b>12,630,000.00</b> |               | <b>247,665,792.00</b> |                |

*Tabela 9: Deklarimi i mjeteve monetare (valutat kryesore) në pikat kufitare Deklarimet sipas llojit të bizneseve 2019*



#### 4.1.4. Ngrirja e transaksioneve bankare

Nëse vlerësohet se ka bazë të arsyeshme për të dyshuar për pastrim parash ose financim të terrorizmit në lidhje me transaksionin ose personin që kryen transaksionin, NjIF-K mund të lëshojë urdhër me shkrim ose urdhër gojor për subjektet raportuese për ngrirjen e përkohshme të transaksioneve për një periudhë maksimale prej dyzet e tetë (48) orëve plus njëzet e katër (24) orë shtesë. Me këtë rast informon prokurorinë dhe organet tjera, kompetente në mënyrë që të marrin masa brenda kompetencave të tyre.



*Për më tepër, NjIF-K mund të lëshojë urdhër me shkrim për ngrirjen e përkohshme të ekzekutimit të transaksioneve, bazuar në kërkesën me shkrim të arsyetuar të çdo homologu të huaj që kryen funksione të ngjashme me NJIF-K, nën kushtet e përcaktuara me këtë ligj dhe si subjekt i reciprocitetit. Po ashtu, NjIF-K mund të kërkojë nga çdo homolog i huaj që kryen funksione të ngjashme me NjIF-K të urdhërojë ngrirjen e përkohshme të transaksioneve nëse ka bazë të arsyeshme për të dyshuar për pastrim të parave ose financim të terrorizmit në lidhje me transaksionin ose personin.*

Grafiku 9: Ngrirja e Llogarisë/Transaksionit 2014-2019

Gjatë 2019, janë nxjerrë 3 urdhra për ngrirjen e përkohshme të transaksioneve, në një vlerë totale prej rreth 151,060 EUR. Duhet theksuar se një urdhër i lëshuar për ngrirje në vitin 2017 në vlerë rreth 1 milion euro, me aktgjykim të Gjykatës është konfiskuar vlera e tërësishme e pasurisë së ngrirë.

| Ngrirja e Llogarisë/Transaksionit 2014-2019                  |         |        |           |           |         |         |
|--|---------|--------|-----------|-----------|---------|---------|
| Urdhërat për ngrirje   | 2014    | 2015   | 2016      | 2017      | 2018    | 2019    |
| Numri i udhëzimeve të lëshuara për pezullim të transaksionit | 20      | 6      | 85        | 3         | 4       | 3       |
| Shuma (EUR)  | 774,115 | 29,740 | 1,036,146 | 1,007,933 | 250,852 | 151,060 |

Tabela 10: Ngrirja e Llogarisë/Transaksionit 2014-2019



#### 4.1.5. Analizimi i raporteve të inteligjencës

NJIF-K, në përputhje me kompetencat e saj, mbledh, përpunon dhe analizon informacione mbi transaksionet dhe aktivitetet financiare që i nënshtrohen analizave financiare, transaksione të tjera financiare ose informacione që mund të lidhen me dyshimin në pastrim të të ardhurave nga krimi, financimi i terrorizmit, dhe veprave të ndërlidhura. Kryesisht informacioni për analizë operacionale dhe strategjike rrjedh nga:

- Subjektet Raportuese,
- Agjencionet e zbatimit të ligjit,
- Mbikëqyrësit e përputhshmërisë,
- Njësitë homologe të huaja

NJIF-K kryen një analizë gjithëpërfshirëse të informacionit të marrë dhe identifikon transaksione të dyshimta financiare të kryera. Të gjitha raportet e marra, analizohen paraprakisht dhe ndahen sipas niveleve të rrezikut dhe i nënshtrohen analizës pasuese, duke marrë parasysh të gjitha informacionet në dispozicion. Pas rezultateve të analizës, krijohen dosje dhe kurdo që është e përshtatshme, NJIF-K gjithashtu mund të ndajnë rezultatet e këtyre analizave me autoritetet përkatëse të zbatimit të ligjit vendor dhe NJIF të huaj për kryerjen e hetimeve të mëtutjeshme financiare.

NJIF-K zhvillon analiza të transaksioneve financiare mbi një qasje të bazuar në rrezik duke marrë parasysh përvojën vendore dhe ndërkombëtare në luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

| <b>Rastet e hapura për analizim 2015-2019</b>  |             |             |             |             |             |
|--|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| <b>Rastet e Hapura</b>   | <b>2015</b> | <b>2016</b> | <b>2017</b> | <b>2018</b> | <b>2019</b> |
| Rastet e hapura bazuar në RTD  | 125         | 180         | 147         | 68          | 64          |
| Propozim rastet e hapura bazuar ne RTD   | 0           | 0           | 0           | 505         | 474         |
| Rastet e hapura nga NJIF-K (informacioni anonim)   | 14          | 18          | 6           | 4           | 6           |
| Rastet e hapura nga Informatat Spontane nga FIU tjera                                      | 1           | 1           | 5           | 5           | 6           |
| Kërkesat për informata   | 106         | 113         | 140         | 159         | 167         |
| Projektet e përbashkëta te analizave/hetimeve me Institucionet tjera te zbatimit te ligjit | 1           | 6           | 12          | 6           | 5           |
| <b>Gjithsej rastet e hapura për analizim</b>   | <b>247</b>  | <b>318</b>  | <b>310</b>  | <b>747</b>  | <b>722</b>  |

Tabela 11: Rastet e hapura 2015-2019



#### 4.1.6. Shpërndarja e raporteve të inteligjencës


Procesi i analizimit të informacionit mbështetet në përvojën ndër vite të krijuar në NJIF-K, njëherit mbështetur edhe në përvojën dhe praktikën më të mira ndërkombëtare.

Procesi i shpërndarjes së informacionit për agjencionet tjera të zbatimit të ligjit kalon nëpër një cikël që përfshin fazën e dhënies së detyrave, mbledhjen, sistemimin, vlerësimin, analizimin dhe shpërndarjen. Ky proces zhvillohet në bazë të procedurave standarde të operimit gjithëpërfshirëse nga analistë me përvojë dhe të kualifikuar, duke përdorur mjete të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit shumë të sofistikuar për futjen, ruajtjen, nxjerrjen e informacionit, përpunimin dhe shpërndarjen. NJIF-K përdor modele të veçanta të vlerësimit të rrezikut duke përdorur vlerat numerike për të përcaktuar kategorinë e rrezikut i cili përshkallzohet në rrezik të ulët, të mesëm ose të lartë.


Mbështetur kryesisht në flukset e raportimit të RTD-ve të dërguara nga subjektet raportuese, të cilat i nënshtrohen procesit të analizimit nga NJIF-K dhe kur evidentohen element të dyshimtë për pastrim të parave, financim të terrorizmit, apo vepra të ndërlidhura, ato shpërndahen për agjencitë e zbatimit të ligjit për veprime të mëtejshme hetimore.

Gjatë vitit 2019, NJIF-K përgatiti dhe shpërndau 151 raporte të inteligjencës, 25% më tepër se vitin paraprak (121 raporte) dhe i dërgoi ato në:


- Policinë e Kosovës - 78 raporte apo 49%
- Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës - 4 raporte apo 3%
- Administratën Tatimore të Kosovës - 52 raporte apo 34%
- Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë - 3 raporte apo 2%
- Agjencinë Kundër Korrupsionit - 1 raport apo 1%
- FIU ndërkombëtare/Informacion Spontan - 15 raporte apo 10%
- tjera - 2 raporte apo 1%



## Raportet e shpërndara të inteligjencës



Grafiku 10: Raportet e shpërndara të inteligjencës 2014-2019



## Raportet e shpërndara të inteligjencës 2014-2019

| Referuar në institucione përkatëse                     | 2014      | 2015      | 2016       | 2017       | 2018       | 2019       | Gjithsej 2014-2019 |
|--|-----------|-----------|------------|------------|------------|------------|--------------------|
| Policia e Kosovës                                      | 27        | 42        | 54         | 60         | 57         | 74         | 314                |
| Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës            | 1         | 9         | 7          | 4          | 8          | 4          | 33                 |
| Administrata Tatimore e Kosovës                        | 21        | 23        | 26         | 40         | 33         | 52         | 195                |
| Dogana e Kosovës                                       | 2         | 6         | 1          | 2          | 2          | 0          | 13                 |
| Agjencia e Kosovës për Inteligjencë                    | 0         | 4         | 0          | 1          | 3          | 3          | 11                 |
| Agjencia Kundër Korrupsionit                           | 0         | 1         | 0          | 3          | 2          | 1          | 7                  |
| EULEX  | 2         | 1         | 13         | 2          | 1          | 0          | 19                 |
| FIU ndërkombëtare/Informacion Spontan                  | 6         | 8         | 11         | 5          | 13         | 15         | 58                 |
| Tjera  | 0         | 0         | 0          | 2          | 2          | 2          | 6                  |
| <b>Gjithsej raportet e shpërndara të inteligjencës</b> | <b>59</b> | <b>94</b> | <b>112</b> | <b>119</b> | <b>121</b> | <b>151</b> | <b>656</b>         |

Tabela 12: Raportet e inteligjencës të shpërndara/referuara në institucione përkatëse 2014-2019



## Një shembull i një dënimit gjyqësor dhe konfiskimit të pasurisë

Të akuzuarit F.S dhe M.S në periudhën kohore nga shkurti 2017 deri në korrik të po atij viti, në vazhdimësi edhe pse e kanë ditur apo kanë pasur arsye për të ditur, se pasuria buron nga aktiviteti kriminal, në bashkëpunim edhe me dy të pandehurit tjerë K.R dhe D.L (shtetas të një vendi të BE-së) , në cilësi të bashkëpronarëve të kompanisë "N" me seli në Prishtinë, me qëllim të përfitimit për vete apo persona tjerë dhe me qëllim të fshehjes së natyres, burimit, vendit, dispozicionit dhe lëvizjes së pasurisë kanë pranuar trjansfere ndërkombëtare (rreth 90 sosh), të gjitha nëpërmjet bankës n] vler] t] përgjithshme prej 1.8 milion euro, kinse në emër të realizimit të të hyrave nga shërbimet e edukimit, shitblerje e metaleve të çmueshme dhe ndërmjetësimit financiar, nga 19 shtete të ndryshme e për të cilat transaksione, nuk kanë poseduar dokument ligjor financiar dhe këtë shumë e kanë bartur apo trabsfeurar fillimisht tek kompania "S" në shetin X të BE-së në shumë prej 742,218 €, kurse ka ngelur i pa realizuar (në tentativë) transferi në vlerë prej 946,820.84 Euro, e cila është dashur të transferohet tek kompania "O" pasi e njëjta shumë është ngrirë dhe këtë veprime inkriminuese është konstatuar nga Gjykata se janë në jubbërshtim të plotë me të gjitha dispozitat ligjore në fuqi.

Me këtë është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale në bashkryerje Shpërlarje parashë nga nenin 308 i KPRK si dhe Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe fiancimin e terrorizmit.

Andaj Gjykata ka dënuar dy personat me burg dhe dënim me gjobë nga 5,000 € secili, si dhe të akuzuarve ju **konfiskohen** pasuria si rezultat i përfitimit nga kryerja e vepërs penale dhe atë në shumë prej **946,820.84 €**.





## 4.2. Mbikëqyrja e Pajtueshmërisë

Mbikëqyrja e pajtueshmërisë është vlerësimi i përmbushjes së obligimeve ligjore nga ana e subjekteve raportuese në pajtim me Ligjin. Sipas Ligjit për PPP/LFT një nga detyrat dhe kompetencat e NJIF-K është të mbikëqyrë dhe monitorojë subjektet raportuese për sa i përket pajtueshmërisë me këtë ligj si dhe me akte nënligjore, urdhrat dhe urdhëresat, që rrjedhin dhe parashihen me këtë ligj, qoftë në terren qoftë në distance.

Sipas nenit 34 të Ligjit mbikëqyrja e pajtueshmërisë mund të kryhet:


- si inspektim në vendin e subjektit raportues; apo
- si mbikëqyrje nga distanca e subjektit raportues

Mbikëqyrja e bazuar në rrezik është e ndërtuar në analizim të përgjithshëm të rrezikut, duke i renditur subjektet e mbikëqyrura në bazë të rrezikut dhe bën një përzgjedhje të bazuar në rrezik përmes analizimit të rrezikut të identifikuar nga subjektet raportuese dhe renditjes në bazë të rezultateve të vlerësimit kombëtar të rrezikut për PP/FT.

Inspektimet mund të klasifikohen në disa mënyra. Klasifikimi varet nga aspektet që merren parasysh. Në këtë PSO inspektimet kryesore janë:

1. Inspektimi me fushëveprim të plotë,
2. Inspektimi me fushëveprim të kufizuar, dhe
3. Inspektimi tematik.
4. Inspektimet “ad-hoc” të paplanifikuara

Gjatë vitit 2019, NJIF-K ka ndërmarrë 25 inspektime të pajtueshmërisë në vend dhe nga distanca, 25% më tepër se vitin paraprak (14 inspektime).



Grafiku 11: Inspektimi i Pajtueshmërisë sipas llojit 2019

| Inspektimi i Pajtueshmërisë sipas llojit 2019 |                     |                        |                  |          |           |
|---|---------------------|------------------------|------------------|----------|-----------|
| Subjektet raportuese                          | Lloji inspektimit   |                        |                  |          |           |
|   | Fushëveprim i plotë | Fushëveprim i kufizuar | Inspektim Pasues | Ad-Hoc   | Gjithsej  |
| Banka   | -                   | 2                      | -                | 1        | 3         |
| Institucione Mikrofinanciare                  | -                   | -                      | -                | 1        | 1         |
| Kompani të Sigurimit dhe Sigurimit të Jetës   | -                   | 2                      | 1                | -        | 3         |
| Agjensione për transferime të parave          | -                   | 1                      | -                | -        | 1         |
| Noterët                                       | -                   | 17                     | -                | -        | 17        |
| <b>Gjithsej Inspektimet e Pajtueshmerise</b>  | <b>0</b>            | <b>22</b>              | <b>1</b>         | <b>2</b> | <b>25</b> |

Tabela 13: Inspektimi i Pajtueshmërisë sipas llojit 2019

| Inspektimet në vend dhe në distancë për periudhën 2014-2019 |      |          |      |          |      |          |      |          |      |          |      |          |
|---|------|----------|------|----------|------|----------|------|----------|------|----------|------|----------|
| Subjektet raportuese të inspektuara                         | 2014 |          | 2015 |          | 2016 |          | 2017 |          | 2018 |          | 2019 |          |
|   | Vend | Distancë | Vend | Distancë | Vend | Distancë | Vend | Distancë | Vend | Distancë | Vend | Distancë |
| Banka   | 9    | -        | 7    | -        | 4    | -        | 1    | 10       | -    | -        | 1    | 2        |
| Institucione Mikrofinanciare                                | 5    | -        | 3    | -        | -    | -        | -    | 15       | 3    | -        | 1    | -        |
| Kompani të Sigurimit dhe Sigurimit të Jetës                 | 6    | -        | 3    | -        | -    | -        | -    | -        | -    | 1        | 2    | 1        |
| Zyrat e Këmbimit Valutor                                    | 7    | -        | 5    | -        | -    | -        | -    | -        | -    | -        | -    | -        |
| Agjencionet për transfere të parave                         | 3    | -        | 2    | -        | -    | -        | 1    | 5        | -    | -        | 1    | -        |
| Kazino dhe Lojëra te Fatit                                  | -    | -        | -    | -        | -    | -        | -    | -        | 4    | -        | -    | -        |
| OJQ   | 5    | -        | 5    | -        | -    | -        | -    | -        | -    | -        | -    | -        |
| Auditor & Kontabilistë                                      | -    | -        | 1    | -        | 1    | -        | -    | -        | -    | -        | -    | -        |
| Noterët   | -    | -        | -    | -        | 10   | -        | 12   | -        | 6    | -        | -    | 17       |
| Agjencionet për patundshmëri                                | -    | -        | -    | -        | 2    | -        | -    | -        | -    | -        | -    | -        |
| Inspektimet në vend dhe distancë                            | 35   | 0        | 26   | 0        | 17   | 0        | 14   | 30       | 13   | 1        | 5    | 20       |
| Gjithsej Inspektimet e Pajtueshmërisë                       | 35   |          | 26   |          | 17   |          | 44   |          | 14   |          | 25   |          |

Tabela 14: Inspektimi i Pajtueshmërisë në vend dhe nga distanca 2014-2019



#### 4.2.1. Ndëshkimet administrative dhe masat për përmirësim

Kur subjekti i mbikëqyrur, me dashje apo nga pakujdesia, shkelë një detyrim të përcaktuar në Ligj në një mënyrë që përshkruhet në nenet 41, 43 dhe 45, NJIF-K do të vendosë sanksione administrative për të ndëshkuar shkeljen e subjektit të mbikëqyrur.

Pas mbikëqyrjes së pajtueshmërisë NJIF-K, BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial ashtu siç përcaktohet në ligj mund të:

- rekomandojnë masat përmirësuese;
- shqiptojnë ndëshkim administrativ; apo
- procedojnë çështjen në procedurë penale

Gjatë përcaktimit të ndëshkimit administrativ merren në konsideratë të gjitha rrethanat relevante, duke përfshirë edhe shkallën dhe kohëzgjatjen e mos-përputhshmërisë, shkallën e përgjegjësisë, fuqinë financiare të subjektit raportues, humbjet e shkaktuar si pasojë e shkeljes, shkeljet e mëparshme si dhe nivelin e bashkëpunimit të subjektit raportues.

Mangësitë e identifikuar gjatë procesit të inspektimit kanë vijuar me identifikimin e shqyrtimit të shkeljeve të evidentuara, pas së cilave NJIF-K ka lëshuar rekomandime për përmirësimin e situatës në subjektet e inspektuara, ka lëshuar ndëshkime administrative si dhe ka vënë në dijeni autoritetet tjera mbikëqyrëse për shkeljet e evidentuara brenda kompetencave të tyre. Gjithsej 41 rekomandime për masat përmirësuese janë dhënë për subjektet e inspektuara, përdërisa janë shqiptuar 7 gjoba në vlerë monetare prej gjithsej 330,000 Euro.

| Ndëshkimet administrative dhe masat për përmirësim 2019 |                                     |                                    |   |
|---|-------------------------------------|------------------------------------|---|
| Subjektet raportuese                                    | Rekomandimet për masat përmirësuese | Numri i Ndëshkimeve administrative | Vlera monetare e gjobave të shqiptuara (Euro) |
| Banka   | 2                                   | 1                                  | 300,000.00                                    |
| Institucione Mikrofinanciare                            | -                                   | -                                  | -   |
| Kompani të Sigurimit & Sigurimit të Jetës               | 2                                   | 1                                  | 20,000.00                                     |
| Zyrat e Këmbimit Valutor                                | -                                   | -                                  | -   |
| Agjencionet për Transfer Parash                         | 3                                   | -                                  | -   |
| Kazinotë dhe Lojërat e Fatit                            | -                                   | -                                  | -   |
| OJQ   | -                                   | -                                  | -   |
| Auditor & Kontabilistë                                  | -                                   | -                                  | -   |
| Noterët   | 95                                  | 1                                  | 10,000.00                                     |
| Avokatët  | -                                   | -                                  | -   |
| Agjentët e patundshmërive                               | -                                   | -                                  | -   |
| Tregtarët me metale/gurë të çmuar                       | -                                   | -                                  | -   |
| <b>Gjithsej</b>   | <b>102</b>                          | <b>3</b>                           | <b>330,000.00</b>                             |

Tabela 15: Ndëshkimet administrative dhe masat për përmirësim 2019

#### 4.2.2. [Aprovimi i zyrtarit të pajtueshmërisë për PPP/LFT](#)

Të gjitha bankat dhe institucionet financiare duhet të dëshmojnë në NJIF-K se personi i emëruar për pajtueshmëri për PPP/LFT i përmbushë kushtet dhe kriteret për i përshtatshëm dhe i duhur për zyrtar të pajtueshmërisë ashtu siç është përcaktuar në Rregulloren Nr. 01/2017 për "Funksionin e Pajtueshmërisë dhe Kriteret për i Përshtatshëm dhe i Duhur për Zyrtarin e Pajtueshmërisë për PPP/LFT".

Aplikimet për aprovimin e zyrtarit të pajtueshmërisë shqyrtohet në harmoni me "kriteret për përshtatshëm dhe i duhur" sipas llojit të subjektit raportues, duke përfshirë një kontroll në sfond për të kaluarën kriminale, konflikt të interesit si dhe njohurive për natyrën e biznesit dhe rreziqeve potenciale të PP/FT.

Funksioni i Pajtueshmërisë për PPP/LFT tek subjektet raportues që nuk kanë kapacitete të mjaftueshme mund të ushtrohet nga Drejtori i subjektit, përveç rasteve kur ky i fundit nuk e përcakton ndonjë person tjetër për ta ushtruar këtë funksion.

Zyrtari i pajtueshmërisë për PPP/LFT është përgjegjës për zhvillimin dhe ruajtjen e mbarëvajtjes së programit të PPP/LFT, duke përfshirë por mos u kufizuar në:

Gjatë vitit 2019 jam pranuar gjithsej 23 aplikacione për aprovimin e zyrtarit të pajtueshmërisë, ku të gjitha janë aprovuar.

- politikat dhe procedurat;
- sigurimin dhe dërgimin e saktë dhe në kohë të raporteve të kërkuara sipas ligjit për PPP/LFT;
- ofrimin e rekomandimeve për menaxhmentin e lartë për ndërmarrjen e masave të duhura për përmirësim;
- ofron rekomandime për ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të TI-së;
- koordinimin e trajnimit për PPP/LFT (me departamentet tjera dhe me punonjësit përkatës brenda bankës apo institucionit financiar); dhe
- mbikëqyrjen e funksionit të monitorimit të transaksioneve dhe raportimeve.

#### 4.2.3. [Udhëzimet, të dhënat statistikore dhe informatat kthyese](#)

NJIF-K gjithnjë është duke modernizuar kornizën e akteve nënligjore dhe udhëzimeve për të gjithë sektorët e raportimit për të siguruar përmbushjen e detyrimeve ligjore në bazë të Ligjit për PPP/LFT në një drejtim më të qartë dhe më konciz.

Gjatë vitit të kaluar, NJIF-K mbajti mbi 20 takime, trajnime dhe ofroj këshilla konsultimi me të detyruarit e ligjit dhe shoqatat e tyre përkatëse të industrisë për të përmirësuar të kuptuarit e tyre për detyrimet e raportimit, si dhe për t'i konsultuar lidhur me udhëzimet e ardhshëm që NJIF-K do të nxjerrë në vazhdimësi.

NJIF-K përdor gjithashtu reagimet e marra (informatat kthyese) nga partnerët e saj të cilat regjistrohen dhe përpunohen në bazën e të dhënave, ku pastaj shërbejnë për të informuar subjektet raportuese për kualitetin e raportimit dhe masat e kontrolleve që janë më efektive në ndalimin e përdorimit të sektorëve të caktuar për PP/FT.



Te dhënat ne vijim tregojnë për numrin e informatave kthese të dërguara nga agjencionet tjera:

| Informatat Kthese nga Institucionet tjera për NJIF-K |      |      |      |
|--|------|------|------|
| Institucioni dërgues                                 | 2017 | 2018 | 2019 |
| Policia e Kosovës                                    | 62   | 11   | 7    |
| ATK  | 9    | 14   | 12   |
| Dogana   | 38   | -    | 10   |
| PSRK   | -    | -    | 1    |
| KKLKE  | -    | -    | 1    |
| AKK  | -    | -    | 1    |
| Gjithsej informata kthese te pranuar nga NJIF-K      | 109  | 25   | 25   |

Tabela 16: Informatat Kthese nga Institucionet tjera për NJIF-K 2017-2019

#### 4.3. Aktivitetet e trajnimeve dhe implementimi i Programit të Trajnimeve

Njësia për Inteligjencë Financiare është autorizuar të organizojë dhe kryejë trajnime të rregullta, përfshirë vetëdijesim dhe sensibilizim në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimit të terrorizmit si dhe detyrimet e subjekteve raportuese.

Gjatë vitit 2019 janë mbajtur pesë (4) trajnime dhe një (1) punëtori me subjektet raportuese në lidhje me masat dhe veprimet që duhen të ndërmerren nga subjektet raportuese me qëllim të parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit, ku gjithsej janë trajnuar 137 zyrtarë nga subjekte të ndryshme raportuese.

| Trajnimet për Subjektet Raportuese 2019 |  |  |                   |
|---|--|--|-------------------|
| Data                                    | Tema   | Audienca   | Prezantuesit      |
| 13/02/2019                              | Obligimet Ligjore për PPP/LFT, Indikatorët, Forma dhe Mënyra e raportimit në NjIF-K                  | Institucionet Financiare Jo Bankare<br>(Leasing dhe Institucionet mikrofinanciare) | NjIF-K            |
| 16/04/2019                              | Obligimet Ligjore për PPP/LFT, Indikatorët, Forma dhe Mënyra e raportimit në NjIF-K, Tipologji       | Auto Sallonet  | NjIF-K            |
| 17/06/2019                              | Vlerësimi i Rrezikut për Parandalimi i Pastrimit të Parave dhe Luftimi i Financimit të Terrorizmit   | Organizatata Jo Qeveritare - OJQ   | NjIF-K<br>PECK II |
| 09/04/2019                              | Obligimet Ligjore të OJQ-ve si subjekte raportuese të përcaktuara me Ligin për PPP/LFT               | OJQ Qatar Charity  | NjIF-K            |
| 31/10/2019                              | Vlerësimi i rrezikut, Masat dhe veprimet për PPP/LFT, Indikatorët, Raportimi në NjIF-K dhe Tipologji | Kontabilistët dhe Auditorët e Certifikuar  | NjIF-K            |

Tabela 17: Trajnimet për Subjektet Raportuese 2019

#### 4.4. Ngritja e kapaciteteve të NJIF-K

##### 4.4.1. Teknologjia Informative

NJIF-K gjatë vitit kalendarik 2019 ka vazhduar progresin në avancimin e Sistemit për Analiza, Raportim dhe Shkëmbim të informacioneve goAML, duke pasur si Objektivë rritjen e kualitetit të Inteligjencës dhe efikasitetin e Analizave.

Poashtu u shënuar edhe avancim në Sistemin e Raportimit përmes goAML duke arritur progres në rritjen e kualitetit të dhënave të cilat raportohen në NJIF.

Progresi u arrit falë një kordinimi të mirë të Sektorit të Teknologjisë Informative dhe Sektorit të Pajtushmërisë të cilat realizuan Inspektime të Përbashkta në Banka dhe Subjekte tjera raportuese. Poashtu pati një Bashkpunim të jashtëzakonshëm me Banka dhe Subjekte tjera raportuese dhe atyre ju asistua pandërprerë me veprimet të cilat duhet të ndërmerren me qëllim të përmisimit të kualitetit të raporteve.

Ekspertët e NJIF-K së bashku me mbështetjen e Projektit të financuar nga BE-ja rikrijoj (rifreskoj) sistemet:

- NJIF-K-ATK i cili i nxjerr, krahason dhe paraqet vizualisht përmes goAML të dhënat e marra nga Baza e të Dhënave të ATK-së dhe sistemit goAML.
- NJIF-K-PK i cili i nxjerr, krahason dhe paraqet vizualisht përmes goAML të dhënat e marra nga Baza e të Dhënave të PK-së dhe sistemit goAML.

Këto sisteme të reja dukshëm kanë lehtësuar procesin e parandalimit të Pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si dhe ndihmojnë shumë në identifikimin e rasteve të mundshme të Kriminalitetit dhe Evazionit Fiskal.

NJIF-K ka realizuar me sukses shumicën të buxhetit vjetor të Njesisë të alokuar për Investime Kapitale. Hardueri (Serverët, Kompjuterët, paisjet tjera) i blerë u integrua tërësisht në sistemin aktual në përdorim duke e rritur ndjeshëm kapacitetin e Analizave përmes Sistemit të Sigurtë. Poashtu u implementua plotsisht sistemi ri i Kamerave dhe Alarmeve dhe u rrit siguria e ndërtesës.

Kanë hy nën ombrellën e raportimit elektronik përmes sistemit elektronik goAML shumë entitete të reja raportuese (Noter, Auditor, Kontabilist etj)

##### 4.4.2. Trajnime, konferenca, seminare dhe takime tjera të ndjekura nga personeli i NJIF-K

Bordi Mbikëqyrës i NJIF-K përmes ngritjes së buxhetit ka mundur ndër të tjera edhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit të njesisë dhe përfitimit të njohurive të reja në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, nëpërmjet trajnimeve të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Për më tepër, NJIF-K ka përfutur edhe nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare përmes pjesëmarrjes në trajnime, seminare, kurse dhe konferenca të organizuara nga KiE (PECK II), UNODC, B&S Project (BE), CEPOL, OSBE, UNDP, Egmont Group, Ambasada Amerikane dhe Britaneze etj. Konkretisht për 2019, 14 zyrtarë të NJIF-K

kanë qenë pjesëmarrës në rreth 37 trajnime, punëtori, vizita studimore etj, ku temat kryesore që janë trajtuar kanë qenë: 'Teknikat e hetimit financiar' dhe krimeve kibernetike, 'mbledhja dhe analiza e Inteligjencës', 'forenzika financiare', 'Pronësinë përfituese', Korrupsioni publik, analiza e vlerës se pasurisë, shpëlarja e parave dhe konfiskimi i pasurisë', 'Tipologjitë e korrupsionit', 'Valutat Virtuale, Pastrimi i parave dhe financimi i Terrorizmit' etj. Në Shtojcën 1 të këtij raporti janë shpalosur detajet që pasqyrojnë pjesëmarrjen në trajnime/punëtori/vizita për vitin 2019 .

#### 4.4.2.1. Vizitat Studimore

Ndërmjet datave 23 dhe 25 shtator, disa nga institucionet kryesore në Kosovë të fushës së PPP/LFT zhvilluan një vizitë studimore në Britaninë e Madhe (UK) në mënyrë që të përfitojnë nga përvojat dhe shembujt e praktikave më të mira në fushat në vijim;

1. Vlerësimet e rrezikut;
2. Qeverisja dhe koordinimi, konsultimi me sektorin privat
3. Zbatimi i Sanksioneve Ndërkombëtare,
4. Pronësia Përfituese dhe Trustet në Mbretërinë e Bashkuar,
5. Mbikëqyrja e sektorit financiar dhe e BPPJF në Mbretërinë e Bashkuar,
6. Inteligjenca Financiare dhe Hetimet,
7. Kthimi i aseteve,
8. Financimi i terrorizmit

Për të arritur synimet dhe objektivat, vizita studimore në Britaninë e Madhe (UK) ka përfshirë institucionet kyçe në vijim: HM Treasury, Departamenti për Biznes, Strategji Industriale dhe Energji dhe Dhoma e Kompanive, Mbikëqyrjen e Specialistëve të Krimeve Financiare, OPBAS dhe Këshillimi dhe Financimi ndaj Krimit Financiar, Autoriteti i Administrimit Financiar, Njësia për Inteligjencë Financiare e Mbretërisë së Bashkuar (UK FIU), Agjencia Kombëtare kundër Krimit, Njësia e Inteligjencës Kombëtare për Financimin e Terrorizmit

Pjesëmarrësve të vizitës studimore u janë paraqitur prezantime nga secila agjenci dhe institucion i Britaninë e Madhe (UK). Ata po ashtu patën mundësi të bëjnë pyetje me interes, duke bërë që vizita të jetë mjaftueshëm interaktive.

Fokus i gjithëmbarshtëm i vizitës studimore ishte që institucioneve kyçe të përfshira në PPP/LFT t'u ofrohet mbështetje dhe ekspertizë për ndërtim të kapaciteteve që ka si qëllim ngritjen e efektivitetit, në veçanti pas Vlerësimit të gjithëmbarshtëm të vendit të kryer nga PECK II sipas metodologjisë së FATF dhe Moneyval; si dhe implementimit të planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të raportit të vlerësimit. Nisur nga kjo perspektivë, është vlerësuar që Britaninë e Madhe (UK) ka kaluar përmes një vlerësimi të FATF-së dhe rezultatet janë mbresëlënëse.

Fusha tjetër e rëndësishme ku institucionet e Britaninë e Madhe (UK) shfaqin shembuj të shkëlqyer të praktikës më të mirë ndërkombëtare është fusha e bashkëpunimit ndërmjet agjencive, veçanërisht në sferën e angazhimit dhe punës ndërmjet agjencive, shembull i tillë është krijimi i disa mekanizmave të koordinimit përfshirë këtu edhe Joint Money Laundering Intelligence Taskforce (JMLIT), një mekanizëm që funksionon mjaft mirë në praktikë.



Përveç kësaj, palët me interes nga Kosova do të mund të nxirrin mësim nga përvoja e fituar në Britaninë e Madhe (UK) lidhur me:

- të kuptuarit e rrezikut, kryerja e një vlerësimi kombëtar të rrezikut dhe përkthimi i saj në politikë,
- mekanizmat kombëtar të koordinimit dhe bashkëpunimi ndërmjet agjencive, përditësimi dhe zbatimi i sanksioneve, listave të eksportit/importit, Ngrirja e Aseteve,
- Struktura e Regjistrimit të MB: struktura, funksionaliteti , regjistrimi i pronarëve përfitues, verifikimi i informacioneve të pronarëve përfitues, Strukturat komplekse dhe përdorimi i të emëruarve , Kompetencat për të detyruar zbulimin e informacionit në lidhje me kujdesin e duhur ndaj klientit,
- Kuptimi i rreziqeve të trustit, Obligimet ligjore rreth trusteve, Regjistri i trusteve të Mbretërisë së Bashkuar dhe pasoja tatimore, Regjistri i planifikuar i trustit,
- Mbikëqyrja e bazuar në rrezik të institucioneve raportuese për qëllime të PPP/LFT, Metodatat e mbikëqyrjes në zyre dhe në terren, Zbatimi i sanksioneve metodologjia dhe praktika, Bashkëpunimi në mes të autoriteteve rreth mbikëqyrjes sektoriale,
- Strategjia e Zyrës për Mbikëqyrje Profesionale të Parandalimit të Pastrimit të Parave (OPBAS) për mbikëqyrjen e BPPJF, Shkëmbim në mes të autoriteteve Kosovare dhe atyre të Mbretërisë së Bashkuar në lidhje me çështjet e mbikëqyrjes
- Zhvillimi i inteligjencës financiare nga FIU e MB dhe autoritetet e zbatimit të Ligjit; Praktikatat e mira për hetimet e pastrimit të parave
- Korniza ligjore dhe institucionale në lidhje me Kthimin e Aseteve, Qasja në informatat financiare të nevojshme për qëllimin e sekuestrimit dhe konfiskimit dhe mekanizmat e bashkëpunimit ndër-institucional, Urdhër e pashpjegueshëm të pasurisë, Menaxhimi i asetëve të konfiskuara dhe të sekuestruara,
- Praktikatat e mira për inteligjencë financiare, hetimet dhe ndjekjet për financimin e terrorizmit.

Pjesëmarrësit për vizitën studimore janë strukturuar rreth: inteligjencës financiare, mbikëqyrjes së pajtueshmërisë, vlerësimit të rrezikut (NJIF-K, BQK, Ministria e Drejtësisë/Dep për profesione të lira); hetimit dhe ndjekjes penale të PP/FT, rikthimi i asetëve dhe konfiskimi (Policia e Kosovës, PSRK dhe Prokuroria e Shtetit); koordinimi nacional dhe hartimit të politikave (Ministria e Financave), Zbatimi i Sanksioneve Ndërkombëtare dhe bashkëpunimi ndërkombëtar (MD/NNJ, MF, NJIF-K, BQK), pronësia përfituese (ARBK dhe institucionet tjera).



Burimi: PECK II



## 5. BASHKËPUNIMI VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR

### 5.1. Bashkëpunimi dhe koordinimi vendor




Parandalimi dhe luftimi i PP/FT dhe krimeve tjera financiare në përgjithësi është i mundur nëse institucionet dhe agjencionet e zbatimit të ligji punojnë bashkërisht në kuadër të kompetencave ligjore që kanë. Shkëmbimi i informacioneve dhe komunikimi në fazën parapenale është me rëndësi për të pasur një qasje më proaktive në fushën e hetimit të PP/FT. Zhvillimi i hetimeve proaktive si dhe përmirësimi, respektivisht ngritja e efikasitetit të


agjencioneve të zbatimit të ligjit dhe institucioneve tjera në shkëmbimin e informacioneve janë sfida të identifikuara edhe në vlerësimet ndërkombëtare të zhvilluara këto vite.

Me qëllim të angazhimit ndërinstytucional është e rëndësishme që të zhvillohen dhe ri-funksionalizohen mekanizmat e përbashkët ekzistues.

Gjatë vitit 2019, NJIF-K ka pranuar 173 kërkesa për shkëmbim të informacionit, 11% më tepër se vitin paraprak (156 kërkesa). Numri më i lartë i kërkesave gjatë vitit 2019 ka rrjedhur nga Policia e Kosovës (92 kërkesa), kurse pjesa tjetër nga AKI (52), Prokuroria e Shtetit (6). Për llogari të autoriteteve të tjera (ATK, Doganë, ILECU, AKK, BQK) janë trajtuar 23 kërkesa për shkëmbim të informacionit.



Grafiku 12: Shkëmbimi i informacionit - vendor '11-'19



Grafiku 12: Kërkesat për informata (IRD) të parashtruar nga institucionet bashkëpunuese të NJIF

## 5.2. Bashkëpunimi me homologët e huaj dhe Grupin Egmont

Një nga komponentët e rëndësishëm të veprimtarisë së NJIF-K është të vendos bashkëpunim sa më të mirë me institucionet ndërkombëtare dhe partnerët e huaj përgjegjës për ndërmarrjen e masave efektive të PPP / LFT.

Gjatë vitit 2019, NJIF-K bashkëpunoi në mënyrë aktive me organizata dhe institucione udhëheqëse ndërkombëtare të angazhuara në këtë fushë, të tilla si Grupi Egmont i Njësive të Inteligjencës Financiare, Projektet e BE dhe Këshillit të Evropës, UNODC, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë. Falë këtij bashkëpunimi dhe mbështetje nga këto organizata, zyrtarët e NJIF-K përfaqësuan përvojën në fushën e PPP/LFT, dhe bashkëpunimin e përmirësuar në nivelin dypalësh gjatë punës, seminareve ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2019 është lidhur marrëveshje e bashkëpunimit (MM) ndërkombëtar me homologen nga Njësia e Inteligjencës Financiare të Malit të Zi dhe iniciuan MM me FIU nga Taiwan.




Në kuadër të bashkëpunimit me grupin Egmont të Njësive të Inteligjencës Financiare, gjatë vitit 2019 NJIF-K ka dërguar informacionin e nevojshëm dhe të frytshëm lidhur me "Egmont Biennial Census 2019", dhe për më tepër ka dhanë kontributin e saj përmes anketave dhe pyetësorëve në hartimin e dokumenteve strategjike dhe udhëzuesve të Egmont Group duke përfshirë:

- IEWG ML of serious Tax Crimes,
- Assessment of the EG IT Business needs – Questionnaire for EUROPE II Members
- EUROPE II Regional Group – Survey regarding the topic of FIU Operational Independence and Autonomy
- Questionnaire on the cooperation between the Financial Intelligence Units and the Customs Authorities

Për më tepër, informacioni jepet për studimet e rasteve që mund të jenë të dobishme në analizimin dhe identifikimin e dobësive që keqpërdoren nga kriminelët për të fshehur pasuritë ose veprimet e pronësisë përfituese.

Në vitin 2019, NJIF-K ka marrë pjesë në takimin e 26 Plenar të Egmont Group të mbajtur në Hagë të Holandës. Delegacioni i NJIF-K i udhëhequr nga Drejtori, mbuluan pjesën më të madhe të grupeve punuese dhe takimet e ndërsjella me homologët e tyre ndërkombëtar. Për më tepër, zyrtarët e njësisë përfituan njohuri dhe ngritje të kapaciteteve përmes pjesëmarrjes në trajnimet e organizuara gjatë takimit plenar. Konkluzionet e Plenares së Egmontit përfshinin përfundimet se si NJIF-ët mund të përfshihen në ngritjen e bashkëpunimit Publiko-Publik (PPC) që do të çojë në identifikimin, të kuptuarit dhe adresimin më të mirë të pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura dhe financimit të terrorizmit. Takimi Plenar vështroj shembujt inovativë të PPC-së, duke marrë parasysh sfidat dhe mundësitë. Përfundimet kryesore ishin si në vijim:

- Partneriteti Publiko-Publik është thelbësor për suksesin në fushën e PPP/LFT;



- Qasja e NJIF-ve në bazat dhe sistemet e të dhënave është thelbësore;
- Gjithmonë ekziston ndërlidhja ndërmjet mbrojtjes së të dhënave, privatësisë dhe sigurisë;
- Konfidencialiteti i informacionit shkëmbyer duhet të garantohet dhe sigurohen rezultatet;
- Respektimi i mandatit unik të secilës palë në një partneritet Publiko-Publik është i domosdoshëm;
- Besimi dhe mirëkuptimi kulturor janë thelbësore.

Po ashtu në fund të vitit, NJIF-K ka marrë pjesë në takimin regional në kuadër të EUROPA II të Egmont Group të mbajtur në Strasburg, Francë. Pjesëmarrësit<sup>3</sup> në këtë aktivitet diskutuan tema me interes si përditësimi i punës për të prodhuar një metodologji për kryerjen e analizave strategjike të pastrimit të të ardhurave nga korrupsioni, zhvillimet rajonale dhe pajtueshmëria etj.

Krerët e Njësive të Inteligjencës Financiare dhe përfaqësues nga 10 vende të Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia, Turqia përfshirë Greqinë dhe Bullgarinë), morën pjesë në takimin e NJIF-ve të rajonit që u mbajt në Ohër, Maqedonia e Veriut më 3-4 Tetor 2019. Pjesëmarrësit në këtë aktivitet diskutuan situatën aktuale të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në rajon me fokus të veçantë në rregullimin e valutave virtuale. Gjatë takimit, NJIF-të diskutuan rreziqet aktuale të PPP / LFT në rajon, si dhe trendët dhe sfidat aktuale në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar.



Burimi: CoE

<sup>3</sup> FIU Guernsey, FIU Gibraltar, FIU Serbia, FIU Bosnia and Herzegovina, FIU Israel, FIU Armenia, FIU Monaco, FIU Albania, FIU North Macedonia, FIU Kosovo, FIU Azerbaijan, FIU Andorra, FIU Georgia, FIU Moldova, FIU Switzerland, FIU San Marino and FIU Ukraine

Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit rajonal, në Nëntor 2019, NJIF-K ka qëndruar për vizitë në Shqipëri ku janë diskutuar temat me interes të përbashkët:

- Tipologjitë e rasteve të dyshimta për PP (veçanërisht me monedha virtuale, kesh-in ndërkufitar, call center etj),
- Inspektimet dhe shqyrtimet (metodologjia e ndjekur),
- Raportet e vlerësimit nga Moneyval,
- Diskutime për NRA respektive,
- Rreziqet e përbashkëta rajonale,
- Komunikimi me FIU-t homolog të Rajonit,
- Komunikimi me vendet perëndimore ku kemi diasporë të përbashkët

### 5.2.1. Shkëmbimi ndërkombëtar i informacioneve

NjIF-i kryen shkëmbimin bazuar në Parimet e Grupit Egmont dhe kanaleve të sigurta të komunikimit. Kompetencat përkatëse të NjIF-it për shkëmbimin ndërkombëtar të informacionit janë paraparë në nenin 14 dhe 15 të Ligjit për PPP/LFT-në. Shkëmbimi ndërkombëtar i informacioneve të NjIF-it rregullohet edhe nga tre PSO të brendshme për procesin e inteligjencës bazuar në goAML, shkëmbimin ndërkombëtar të informacionit dhe mbi procesin e NjIF-it për analiza dhe inteligjencë.



Gjatë vitit 2019 janë shkëmbyer rreth 134 informata me homologët e huaj. Shumica e kërkesave (rreth 53%) për shkëmbim ndërkombëtar të informacionit midis NjIF-eve ishin kërkesa nga vendet e Bashkimit Europian. Përderisa rreth 26% ishin nga vendet e rajonit, ndërkohë që përqindja e përafërt apo 21% ishte nga vendet e tjera jashtë kontinentit. Ky trend i shkëmbimit të informacionit është edhe në përputhje me profilin e rrezikut.

*Neni 62 i Ligjit aktual për PPP/LFT-në parasheh shkallën më të gjerë të bashkëpunimit ndërkombëtar, duke paraparë që autoritetet kompetente të Kosovës të ndërmarrin sigurimin e masave më të gjera të mundshme të bashkëpunimit me autoritetet e shteteve të huaja për të shkëmbyer informacione, hetime dhe procedura gjyqësore lidhur me masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë dhe urdhrave për konfiskim në lidhje me mjetet e pastrimit të parave dhe pasurinë e fituar nëpërmjet veprës penale dhe me qëllim të ndjekjes penale të kryerësve të pastrimit të parave dhe aktivitetit terrorist.*





| Shkëmbimi ndërkombëtar i informatave 2015-2019                           |           |           |           |           |           |            |
|--|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|------------|
| Bashkëpunimi ndërkombëtar  | 2015      | 2016      | 2017      | 2018      | 2019      | Gjithsej   |
| <b>KËRKESAT E PRANUARA</b>   |           |           |           |           |           |            |
| Kërkesat e huaja të pranuar nga NjIF-K                                   | 18        | 16        | 33        | 32        | 26        | 125        |
| Kërkesat e huaja të refuzuara nga NjIF-K                                 | 0         | 0         | 0         | 0         | 0         | 0          |
| Ndarja spontane e informacionit të marrë nga NjIF-K                      | 1         | 1         | 7         | 12        | 19        | 40         |
| <b>GJITHSEJ (kërkesat dhe informacioni i pranuar)</b>                    | <b>19</b> | <b>17</b> | <b>40</b> | <b>44</b> | <b>45</b> | <b>165</b> |
| Numri mesatar i ditëve për t'iu përgjigjur kërkesave të NJIF-ve të huaja | 23        | 16        | 13        | 19        | 14        |            |
| Arsyet e refuzimit të zbatuara   | 0         | 0         | 0         | 0         | 0         | 0          |
| <b>KËRKESAT E DËRGUARA</b>   |           |           |           |           |           |            |
| Kërkesat e dërguara nga NjIF-K   | 18        | 13        | 37        | 62        | 74        | 204        |
| Ndarja spontane e informacionit të dërguar nga NjIF-ët                   | 8         | 11        | 5         | 13        | 15        | 52         |
| <b>GJITHSEJ (kërkesat dhe informacioni i dërguar)</b>                    | <b>26</b> | <b>24</b> | <b>42</b> | <b>75</b> | <b>89</b> | <b>256</b> |

Tabela 18: Shkëmbimi ndërkombëtar i informatave 2015-2019




Grafiku 13: Kërkesat e huaja të pranuar nga NjIF-K





Grafiku 14: Kërkesat e dërguara nga NjIF-K tek homologët e huaj


Koha mesatare e kthimit të përgjigjeve ndaj kërkesave ndërkombëtare ka rënie në vitin 2019 (14 ditë mesatarja), krahasuar me 19 ditë sa ishte vitin paraprak, gjë që konsiderohet si përparim në adresimin e kërkesave për shkëmbim ndërkombëtar të informacionit. NjIF-K ka hartuar procedura standarde të operimit dhe përcaktuar afatet për t'iu përgjigjur kërkesave ndërkombëtare. Për këtë qëllim, NjIF-K i kushton vëmendje të veçantë kërkesave ndërkombëtare dhe bën përpjekje për të ekzekutuar në mënyrë efikase kërkesat ndërkombëtare në kohën e duhur dhe pa vonesa të paarsyeshme.



Grafiku 15: Numri mesatar i ditëve për t'iu përgjigjur kërkesave të huaja 2012-2019

Shkëmbimi spontan i inteligjencës financiare ka ardhur gjithnjë në rritje ku në vitin 2019 është shënuar ngritje prej 42% krahasuar me vitin 2018. NjIF-ët kryesore me të cilët NJIF-K shkëmben informacion spontan janë: Shqipëria, Gjermania, SH.B.A, Austria, Maqedonia Veriore etj





Grafiku 16: Ndarja spontane e informacionit 2013-2019

NjIF-i nuk ka nevojë për Marrëveshje Mirëkuptimi si parakusht për shkëmbimin e informacionit, megjithatë ka arritur 18 Marrëveshje Mirëkuptimi, përfshirë rishikimet dhe ripërtëritjet e Marrëveshjeve të Mirëkuptimit me disa vende, duke shfaqur kështu përpjekje shtesë për t'u angazhuar në shkëmbim të informacionit me partnerët rajonalë më të rëndësishëm.

| MoU të nënshkruara nga NJIF-K me homologët e huaj            |      |
|--|------|
| Juridiksioni   | Viti |
| Shqipëria (DPPPP)  | 2009 |
| "Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë" (MLPD)               | 2009 |
| Mali i Zi (APML)   | 2009 |
| San Marino (FIA)   | 2009 |
| Sllovenia (OMLP)   | 2009 |
| Kroacia (AMLO)   | 2010 |
| Turqia(MASAK)  | 2012 |
| Republika Çeke (FAU-CR)                                      | 2012 |
| Finlanda (FIU)   | 2013 |
| Polonia (GIIF)   | 2014 |
| Shqipëria (DPPPP) - ripërtëritje                             | 2014 |
| Hungaria (HFIU)  | 2015 |
| "Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë" (FIO) - ripërtëritje | 2015 |
| Gana (FIC)   | 2015 |
| Lituania (FNNT)  | 2016 |
| Jordania (AMLU)  | 2018 |
| Senegal (CENTIF)   | 2018 |
| Mali i Zi (FIU)  | 2019 |

Tabela 19: MoU të nënshkruara nga NJIF-K me homologët e huaj



## 6. MENAXHIMI I RREZIKUT NË PASTRIM TË PARAVE DHE FINANCIM TË TERRORIZMIT

### 6.1. Strategjitë Kombëtare dhe Planet e Veprimit për PPP/LFT

Strategjia e luftës kundër ekonomisë joformale, parandalimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023 është një dokument i hartuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në bashkëpunim të plotë me partnerët e saj. Ky dokument mbulon tërësinë e masave që Qeveria synon të realizojë përmes institucioneve të saj ligj zbatuese parandalimin e të gjitha formave të ekonomisë joformale, parandalimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe Krimeve Financiare në sektorë të ndryshëm të aktiviteteve ekonomike në Kosovë përmes Planit të Veprimit 2019-2023.

Planifikimi strategjik për parandalimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare në Kosovë, bazohet në menaxhimin e rrezikut, me qëllim që institucionet përkatëse kombëtare të jenë në gjendje të menaxhojnë dhe të kontrollojnë aktivitetet e tyre, në lidhje me rreziqet e mundshme në të ardhmen. Procedura e menaxhimit të rrezikut është në përputhje me Udhëzimin e Vlerësimit të rrezikut Kombëtar të TFVF-së për pastrimin e parasë dhe financimin e terrorizmit si dhe standardet ndërkombëtare ISO 31000 (2009) dhe 31010 (2009).

Objektivat strategjikë që synohen të arrihen nëpërmjet kësaj strategjie janë: Përmirësimi i cilësisë së qeverisjes në ekonomi nëpërmjet identifikimit, analizimit,

- trajtimit dhe monitorimit të luftimit të ekonomisë joformale, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit Rritja e burimeve financiare për shërbimet publike si rezultat i të hyrave shtesë
- tatimore dhe nga konfiskimi i pasurisë së paligjshme

Realizimi i objektivave strategjike të mësipërm do të bëhet nëpërmjet katër objektivave specifike sasior dhe 3 objektivave specifik cilësor, të cilat janë formuluar në pajtim me ciklin e formulimit dhe zbatimit të politikave publike.

Edhe gjatë vitit 2019 NJIF-K ka vazhduar zbatimin e aktiviteteve që dalin nga Strategjitë Kombëtare duke raportuar në baza të rregullta periodike përmbushjen e objektivave dhe progresin. Kontributi i NJIF-K ka vazhduar në implementimin dhe rishikimin e strategjive kombëtare duke qenë pjesëmarrëse aktive në:

- Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023,
- Strategjinë Kombëtare kundër Krimit të Organizuar 2018-2022,
- Strategjinë Kombëtare kundër Terrorizmit 2018-2023,
- Strategjinë dhe planin e veprimit për implementimin e strategjisë për parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm 2015-2020,
- Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA),  
✓ Kapitulli 4 i acquis-së: Lëvizja e lirë e kapitalit





- ✓ Kapitulli 24 i acquis-së: Drejtësia, liria dhe siguria
- Planin Vjetor të Punës së Qeverisë 2019, dhe
- Planin e punës së Ministrisë së Financave për Vitin 2019.

## 6.2. Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar për PP/FT

Në gusht të vitit 2019 është përmbyllur vlerësimi gjithëpërfshirës i rrezikut kombëtar të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (VRK) që ka identifikuar rreziqet, kërcënimet dhe dobësitë në sektorin financiar dhe jofinanciar që do të përdoret për të zhvilluar masa të përshtatshme për të përmirësuar regjimin e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit. Vlerësimi është rishikuar dhe miratuar nga Grupi Punues. Vlerësimi pret miratimin nga Bordi Mbikëqyrës i NJIF-K dhe miratimin nga Qeveria. Disa punëtori janë organizuar nga UNDP, së bashku me NJIF-K, për të analizuar rreziqet dhe për të mbledhur të dhëna në lidhje me sektorët e rrezikut të identifikuar për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.



## 7. MBËSHTETJA NDËRKOMBËTARE

### 7.1. Projektet e financuar nga BE-ja&KiE


Projekti i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës kundër Krimin Ekonomik në Kosovë (PECK II) ka mbështetur NJIF-K si përfitues kryesor dhe institucione të tjera edhe gjatë vitit 2019. Aktivitetet kryesore të zhvilluara gjatë këtij viti ishin përqendruar në pronësinë përfituese, mbikëqyrjen e bazuar në rrezik, shpërndarjen e inteligjencës dhe shkëmbimin e informacionit, rishikimin e legjislacionit në fushën e PPP/LFT, Sanksione të Shenjtruara Financiare, ngritjen e vetëdijesimit në sektorët e cenueshëm etj. Në vijim janë paraqitur aktivitetet kryesore të zhvilluara gjatë kësaj periudhe:

Më 31 janar dhe 1 shkurt 2019, një mision faktmbledhës me qëllim të rishikimit të kornizës rregullatore të pronësisë përfituese është organizuar në Prishtinë. Eksperti i Këshillit të Evropës ka mbajtur takime me institucione përkatëse duke përfshirë, mes tjerash: Njësinë për Inteligjencë Financiare, Banka Qendrore, Sektori Bankar dhe Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve. Institucionet qeveritare dhe sektori bankar e kanë mirëpritur këtë iniciativë për të rregulluar këtë temë për arsye të sfidave me të cilat përballen në punët e tyre ditore. Për më tepër, institucionet kanë mirëpritur idenë e një Regjistri të Pronësisë Përfituese.

Më 26-27 shkurt 2019, një punëtori dy-ditore me temë vlerësimi e rreziqeve të financimit të terrorizmit nga organizatat jo-fitimprurëse (OJF) është organizuar në Tivat, Mal të Zi nga Juridiksionet Perëndimore të Ballkanit dhe Turqia. Me pjesëmarrje nga zyrtaret dhe ligjvënësit, punëtorja me temë “Kryerja e vlerësimeve të rrezikut për të luftuar financimin e terrorizmit në sektorin jo-fitimprurës” me qëllim të lehtësimit të kuptimit të përbashkët të standardeve dhe praktikave krahasuese në lidhje me financimin e terrorizmit, metodologji të vlerësimit të rrezikut dhe mbikëqyrje të sektorit të OJF-ve. Dy përfaqësues nga NJIF-K kanë marrë pjesë në këtë punëtori.

Më 5 dhe 6 mars 2019, një punëtori dy-ditore me qëllim të përmirësimit të metodologjive dhe praktikave të mbikëqyrjes PPP/LFT është mbajtur nga Projekti PECK II në Prevallë. Përfaqësues nga NJIF-K, Banka Qendrore, si dhe nga mbikëqyrës të tjerë sektorialë të fushave të PPP/LFT duke përfshirë Oden e Noterëve, Odën e Avokatëve, Administratën Tatimore, Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve të certifikuar, Departamenti për Profesionet të Lira dhe Agjencia e Metrologjisë së Kosovës kanë pasur mundësinë të diskutojnë dhe krahasojnë praktikën më të mirë në një qasje të bazuar në rrezik ndaj aktiviteteve PPP/LFT së bashku me ekspertin e Këshillit të Evropës.

Më 14 dhe 15 mars 2019, Projekti PECK II ka mbajtur një punëtori dy ditore për të diskutuar rolin dhe rëndësinë e shpërndarjes së inteligjencës në mes të NJIF-K dhe institucionet bashkëpunëtoresh. Përfaqësues nga NJIF-K, Policia, Dogana, Administrata Tatimore, Agjencia kundër Korrupsionit, ILECU, Qendra Kombëtare e Menaxhimit të Kufijve dhe Agjencia e Inteligjencës së Kosovës kanë paraqitur praktikën që përdoren momentalisht nga institucionet e tyre për të shpërndarë inteligjencë, gjë e cila mundësoi vëzhgimin e mangësive dhe reflektimin



rreth nevojave për një qasje unike e cila do të jetësohej përmes Procedurave Standarde të Operimit.



Burimi: PECK II

Me 28 dhe 29 mars 2019, anëtarë të Grupit Punues ndërmintor të mandatuar për hartimin e Ligjit për Sanksione të Shenjtestuara Financiare janë takuar në Istog për të diskutuar me ekspertin e Këshillit të Evropës rreth përputhshmërisë së draft ligjit të tanishëm me standardet Evropiane dhe ndërkombëtare dhe më specifikisht Rekomandimet 6 dhe 7 të Task Forcës së Veprimit Financiar. Gjatë këtij aktiviteti, grupi punues ka finalizuar draft ligjin duke i pasqyruar në masë të madhe rekomandimet e propozuara nga eksperti i Këshillit të Evropës dhe kontributet nga institucione të ndryshme.

Më 7 maj 2019, Këshilli i Evropës ka organizuar një punëtori për t'i siguruar institucionet e qeverisë me këshillim konkret rreth masave të mëtejme për të identifikuar dhe verifikuar pronarët përfitues dhe për të kufizuar keqpërdorimin e personave juridik dhe aranzhimet ligjore për qëllime të PP/FT. Për këtë qëllim, është prezantuar dokumenti teknik për pronësinë përfituese, i përgatitur nga Projekti PECK II. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte siguri i mbështetjes për institucionet relevante në zbatimin e rekomandimeve nga raporti i vlerësimit të PECK II lidhur me pajtueshmërinë e Kosovës me standardet ndërkombëtare të parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit në raport me pronësinë përfituese.

Më 14 dhe 15 maj 2019, në bazë të kërkesës së institucioneve përfituese, Projekti PECK II ka mbështetur grupin e parë ndërmintor të mandatuar për të zhvilluar koncept dokumentin për amendamentimin e legjislacionit lidhur me Parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit (PPP/LFT). Vendimi për të ndryshuar legjislacionin është bazuar në gjetjet e rekomandimet e dala nga raporti i vlerësimit të PECK II lidhur me pajtueshmërinë e Kosovës me standardet ndërkombëtare të PPP/LFT. Duke pasur parasysh se ky ishte takimi i parë, diskutimet janë fokusuar në fushat prioritare përfshirë nevojën për të qartësuar përkufizimin e kundërvajtjes së pastrimit të parave, konfiskimin e parave të gatshme, çështje të ndërlidhura me obligimet e Organizatave jo Fitimprurëse si entitete raportuese, kujdesin e shtuar ndaj klientëve të thjeshtuar, rregullimin e pronësisë përfituese.

Më 17 qershor 2019, Projekti PECK II në bashkëpunim me Njësinë për Inteligjencë Financiare ka organizuar një tryezë të rrumbullakët informuese me përfaqësues të OJF-ve të nivelit qendror. Qëllimi i aktivitetit ka qenë informimi i OJF-ve rreth obligimeve të tyre në lidhje me PPP/LFT. Për më tepër, aktiviteti kishte po ashtu për qëllim të ndaj mësimet e marra në lidhje

me rrezikun e financimit të terrorizmit në sektorin e OJF-ve nga punëtorja rajonale të organizuar nga Këshilli i Evropës në Tivat – Mal të Zi, në Shkurt 2019.

Nga 23 deri më 25 shtator 2019, Projekti PECK II ka organizuar një vizitë studimore për autoritetet e Kosovës në Thesarin e Shkëlqesisë së Saj (Londër, Mbretëri e Bashkuar). Qëllimi i vizitës ka qenë diskutimi i praktikave të mira me homologët nga MB në fushat e PPP/LFT dhe më specifiku, çështjeve të identifikuar si të nevojshme për t'u zhvilluar në bazë të vlerësimit të PPP/LFT nga PECK II, duke përfshirë mbikëqyrjen financiare, vlerësimin e rrezikut kombëtar, pronësia përfituese, bashkëpunimi ndërkombëtar, konfiskimi/rikthimi i asetëve dhe financimi i terrorizmit. Gjatë takimeve, pjesëmarrësit kanë pasur mundësinë të dëgjojnë rreth dobive të bashkëpunimit në mes të sektorit të zbatimit të ligjit dhe atij privat, përfshirë bankat si sektor me rrezik të lartë për pastrim të parave.

#### 7.1.1. [Projekti i KiE&BE "iPROCEEDS" 2](#)

Në fund të vitit 2019, KiE&BE kanë lansuar projektin iPROCEEDS<sup>4</sup> në kuadër të IPA-s për bashkëpunimin në lidhje me krimet kibernetike i cili është një projekt i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.

Përfitues të këtij projekti janë vendet: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia, Turqia dhe Kosova.

Objektivi i këtij projekti është forcimi i më tej i aftësive të autoriteteve në vendet përfituese për të kërkuar, ngrirë dhe konfiskuar të ardhurat e krimit kibernetik dhe parandalimin e pastrimit të parave në internet dhe për të siguruar prova elektronike.

NJIF-K së bashku me institucionet tjera të zbatimit të ligjit kanë marrë pjesë në hartimin e termave të referencës si dhe janë përfituese direkte të këtij Projekti i cili do të filloj më 1 Janar 2020 dhe do të përfundoj më 30 Qershor 2023. Vlera e projektit është 4, 945, 000 EURO.

#### 7.2. [Mbështetja nga UNDP](#)

##### **Mbështetja e UNDP ndaj përpjekjeve antikorrupsion në Kosovë (SAEK II) - Mbështetja për NJIF-K në vitin 2019**

- **UNDP SAEK ka mbështetur NJIF-K në zhvillimin e vlerësimit gjithëpërfshirës të rrezikut kombëtar të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit (VRK)** që ka identifikuar rreziqet, kërcënimet dhe dobësitë në sektorin financiar dhe jofinanciar që do të përdoret për të zhvilluar masa të përshtatshme për të përmirësuar regjimin e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Vlerësimi pret miratimin nga Bordi Mbikëqyrës i NJIF-K dhe miratimin nga Qeveria. UNDP ka mbështetur NJIF-K dhe grupin punues të VRK përmes këshillave teknike, pyetësorëve të hartuar posaçërisht për zbatuesit e ligjit, gjyqësorin, autoritetet e mbikëqyrjes financiare dhe subjektet raportuese të sektorit privat. Disa punëtori janë organizuar nga UNDP, së bashku me

<sup>4</sup> Joint project of the European Union and the Council of Europe



NJIF-K, për të analizuar rreziqet dhe për të mbledhur të dhëna në lidhje me sektorët e rrezikut të identifikuar për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

- **Me mbështetjen e UNDP SAEK II i është mundësuar qasja NJIF-it në bazën e të dhënave Worldcheck** e cila është pasuar me miratimin e kriterëve të cilat janë të obliguara të zbatohen gjatë analizës paraprake për Raportet e Transaksioneve/Aktiviteteve të dyshimta në veçanti me PEP-at. Sistemi ka rezultuar jashtëzakonisht i dobishëm në mbledhjen e inteligjencës dhe vazhdimisht çon në hetime të përmirësuar. Rezultatet e analizave të siguruara përmes bazës së të dhënave tani ndahen rregullisht me Policinë, AKI, Administratën Tatimore dhe Doganën etj.
- Gjithsej 43 zyrtarë, duke përfshirë 3 analistë të NJIF-K janë certifikuar në ekzaminimin e mashtrimit dhe forenzikës financiare përmes një kursi të posaçëm të akredituar të krijuar dhe zhvilluar nga UNDP SAEK dhe SHKÇAK të cilët tani janë duke përdorur aftësitë e tyre të reja për të zbuluar krimet financiare. Si vazhdimësi, janë mbajtur trajnime ekspertët e certifikuar.

#### **Plani për mbështetjen e NJIF-K nga UNDP SAEK në 2020-2024**

- **UNDP SAEK aktualisht është në proces të mbështetjes së NJIF-K në hartimin e tipologjive të përgjithshme të pastrimit të parave.** Zyrtarët e emëruar nga NJIF-K për të shqyrtuar rastet e pastrimit të parave që tregojnë trendet në sektorët e identifikuar përmes Vlerësimit të Riskut Kombëtar të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Këto Tipologji do të zhvillohen nga projekti, së bashku me NJIF-K, në ilustrime të çështjeve dhe përshkrime të cilat elemente duhet të identifikohen kur merren me klientë të dyshimtë, dhe aktivitete financiare për të gjithë sektorët e rrezikut të identifikuar përmes Vlerësimit Kombëtar të Riskut.
- **UNDP SAEK, së bashku me NJIF-K, po zhvillojnë një rast video për ngritjen e vetëdijesimit dhe aplikimin për çmimin më të mirë ndërkombëtar në Egmont (BECA).** Kjo do të ofroj një mundësi të vlefshme për NJIF-K për të shkëmbyer njohuritë, ekspertizën dhe përvojat brenda komunitetit global të PPP / LFT. NJIF-K do të garojë në konkurs me një rast video duke ilustruar konfiskimin e suksesshëm të 1 milion eurove që përfshin një skemë globale mashtrimi përmes valutave virtuale, me vlerë miliarda euro. Rasti ilustron punën e jashtëzakonshme analitike të NJIF-K, bashkëpunimin e tyre me Prokurorinë dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, subjektet raportuese si dhe me 17 njësi homologe nga juridiksione të ndryshme të botës.
- UNDP SAEK III do të vazhdojë të përqendrohet në zbatimin e masave dhe mbështetur NJIF-K për të monitoruar në mënyrë efektive transaksionet financiare nga persona të ekspozuar politikisht (PEP) dhe bashkëpunëtorët e tyre, dhe të sigurojë mbështetje teknike për forcimin e mëtutjeshëm të rolit thelbësor të NJIF-K në zbulimin e korrupsionit dhe krimin financiar dhe rikuperimin e aseteve të fshehura dhe përfituara nga aktivitetet e paligjshme. Hetimet e suksesshme të PEP-ve dhe bashkëpunëtorëve të tyre kërkojnë koordinim midis NJIF (për për të dhëna financiare), Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit (për pasuritë e zyrtarëve publikë dhe deklarimit të pasurisë), Administratën Tatimore (për të dhënat tatimore), Regjistrin e Biznesit (për strukturat e pronësisë së kompanive) dhe Agjencisë Kadastrale (për regjistrimet e pasurive). Gjatë gjithë aktiviteteve të projektit për të mbështetur gjykimin me sukses të veprave të korrupsionit, vëmendje e veçantë i është kushtuar modernizimit të inteligjencës efektive dhe shkëmbimit të të dhënave duke përdorur qasje direkte në të dhëna të zhvilluara përmes SAEK II. Për t'i forcuar dhe bërë të qëndrueshme këto përpjekje, **SAEK III do të**

**mbështesë NjIF-në në krijimin e një strukture të re të Analizës Strategjike, e cili do të jetë e ngarkuar me analizën e rreziqeve, kërcënimeve dhe dobësive brenda Kosovës në lidhje me shërbimet financiare dhe jo-financiare të përdorura për pastrim parash ose financim të terrorizmit.** Për më tepër, kjo strukturë e re do të ketë për detyrë të përmirësojë masat e shkëmbimit të të dhënave me sistemin e deklarimit elektronik të Agjencisë Kundër Korrupsionit për pasuritë dhe të ardhurat e zyrtarëve publik, të dhënat e patundshmërive, taksave dhe të dhënat doganore. Struktura e planifikuar e Analizës Strategjike brenda NjIF-K do të luftojë në mënyrë proaktive pastrimin e parave, përfshirë atë që përfshin PEP, përmes analizave të trendëve dhe metodave të reja për përmirësimin e hetimeve dhe mbylljen e boshllëqeve që lejojnë keqpërdorimin e sistemit financiar.

- **UNDP SAEK III do të mbështesë zhvillimin e zyrës për rikuperimin e pasurive e cila do të jetë e ngarkuar me zbulimin dhe rikthimin e pasurive të fshehura brenda dhe jashtë vendit.** Për këtë qëllim do të mbështetet NjIF-K së bashku me Zyrën e Kryeprokurorit, Policinë, Administratën Tatimore dhe Doganat. Zyra do të përdor teknika të specializuara hetimore dhe mjete online për të zhvilluar raste, si dhe bashkëpunim të shtuar me juridiksione të huaja për të rikuperuar pasuritë e përfituara jashtëligjshëm të fshehura jashtë vendit.
- **UNDP SAEK III do të sigurojë mbështetjen e NjIF për të mundësuar qasje në bazat e të dhënave të krijuara posaçërisht për të gjurmuar asetet e personave fizikë dhe juridikë në mënyrë që ajo të ndihmojë në rikthimin e pasurive.** UNDP SAEK III do të mbështesë NjIF në zhvillimin e udhëzimeve dhe trajnimeve për sektorin privat në identifikimin e rreziqeve të pastrimit të parave (bazuar në NRA) dhe zhvillimin e vlerësimeve të brendshme të rrezikut për subjektet raportuese.

### 7.3. Mbështetja nga CEPOL-it

#### Programi i shkëmbimit me NjIF-Portugali përmes CEPOL-it



CEPOL është Agjencia e Bashkimit Evropian për Trajnimin e Institucioneve të Zbatimit të Ligjit, e cila ka për detyrë të organizojë trajnime për oficerët e zbatimit të ligjit në Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian (BE). CEPOL filloi të funksionojë në vitin 2001 dhe siguroi trajnime për oficerët dhe ekspertët e lartë të Policisë dhe në vitin 2016 zgjeroni mandatin e tij për të gjithë Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit të të gjitha niveleve.

Në kuadër të programit të shkëmbimit të CEPOL-it për Ballkanin Perëndimor për Hetimet Financiare, në vitin 2019, NjIF-K ka realizuar shkëmbim me Njësinë për Inteligjencë Financiare të Portugalisë.

Në muajin Qershor kemi pritur për vizitë njëjavore zyrtarin nga NjIF-Portugali, me të cilin kemi vizituar përveç NjIF-K edhe Doganën e Kosovës, Administratën Tatimore të Kosovës, Bankën Qendrore të Kosovës dhe Policinë e Kosovës -Drejtorinë Kundër Terrorizmit, ku kemi diskutuar në lidhje me bashkëpunimin dhe koordinimin e aktiviteteve me qëllim të luftimit dhe parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Gjithashtu, gjatë këtyre takimeve kolegu nga Portugalia ka shpalosur përvojën e NjIF-Portugali në bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse për PPP/LFT në Portugali.

Në muajin Shtator, një zyrtar nga NJIF-K ka vizituar Portugalinë dhe në kuadër të kësaj vizite ka takuar zyrtarë nga NJIF-Portugali, Policinë Gjyqësore konkretisht Njësitë Kundër Korrupsion, Krime Kibernetike dhe Njësinë Kundër Terrorizmit. Gjithashtu, janë mbajtur takime me zyrtarë nga Banka Qendrore e Portugalisë, Autoritetin Ekonomike dhe Sigurisë Ushqimore si dhe Zyrën për Kthimin e Pasurisë.



## 8. PLANI I PERFORMANCËS DHE RESURSEVE TË NJIF-K

Në fund të vitit 2019, NJIF-K ka hartuar Planin e Performancës dhe Resurseve 2020-2022, i cili përshkruan detyrat, misionin, vizionin, qëllimet, prioritetet strategjike, objektivat dhe veprimet e Njësisë për Inteligjencën Financiare të Kosovës (NjIF-K). Ky plan gjithashtu përmban planin për alokim të resurseve dhe kontroll të brendshëm.

Plani i performancës dhe resurseve 2020-2022 përcakton se si NjIF-K do të bazohet dhe mbështetet në asetet e saj dhe të arriturat për t'i përmbushur dhe tejkaluar sfidat me të cilat do të ballafaqohet gjatë periudhës tri vjeçare dhe se si do të mbajë pozitën e vet si një ndër njësitë kredibile të inteligjencës në Kosovë dhe në rajon. Ky plan gjithashtu tregon se si NjIF-K do të matë suksesin e vet dhe si do të kontrollojë proceset e veta të brendshme

Qëllimi strategjik i NjIF-K është të sigurojë një regjim efikas për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit në Kosovë duke zhvilluar proceset e veta të brendshme dhe metodat e punës të orientuara kah performanca, korniza ligjore dhe bashkëpunimin me partnerët kombëtar dhe ndërkombëtar.

Prioritetet Strategjike dhe objektivat e planit të performancës së NjIF-K në nivel institucional rezultojnë prej planeve të veprimit të strategjive kombëtare, vlerësimit të rreziqeve kombëtare dhe sektoriale, vlerësimit të gjithëmbarshtëm të vendit në fushën e PPP/LFT, programit të Qeverisë, PKZMSA, ERA, buxhetit dhe raporteve dhe dokumenteve tjerë që janë në interes për NJIF-K.

NjIF-K monitoron progresin drejt arritjes së prioriteteve strategjike përmes objektivave specifike dhe llogari-dhënëse, të cilat implementohen duke u bazuar në planet e veprimit. Suksesi i institucionit vlerësohet duke përdorur indikatorët kyç të performancës.

### 8.1. *Objektivat për të ardhmen në përmbushjen e planit të performances dhe strategjive tjera kombëtare*

Janë përcaktuar 6 Prioritete kryesore strategjike të NJIF-K për periudhën 2020-2022, të cilat janë paraqitur siç vijon:

- **Prioriteti Strategjik 1 - Politikat dhe koordinimi vendor për PPP/LFT-në;**
  - ✓ Objektivi specifik 1.1.: Fuqizimi i vlerësimit të rrezikut, menaxhimit të rrezikut dhe kornizës strategjike;
  - ✓ Objektivi specifik 1.2.: Bashkëpunimi & Koordinimi Kombëtar dhe rishikimi i efektivitetit të sistemit kombëtar të PPP/LFT;
  - ✓ Objektivi specifik 1.3.: Përforcimi i partneritetit publik-privat;
  - ✓ Objektivi specifik 1.4.: Rritja e vetëdijesimit dhe komunikimit për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit;
  - ✓ Objektivi specifik 1.5.: Trajnimet





- **Prioriteti Strategjik 2 - Fuqizimi i strukturës së përgjithshme të kornizës mbikëqyrëse dhe masat parandaluese;**
  - ✓ Objektivi specifik 2.1.: Promovimi i parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
  - ✓ Objektivi specifik 2.2.: Intensifikimi i mbikëqyrjes së bazuar në risk;
  - ✓ Objektivi specifik 2.3.: Ngritja e bashkëpunimit për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë;
  - ✓ Objektivi specifik 2.4.: Sigurimi dhe vendosja e sanksioneve proporcionale dhe zhbindëse që parashihen nga Ligji për PPP/LFT-në për mos-pajtueshmërinë e konstatuar nga subjektet raportuese
  
- **Prioriteti Strategjik 3 - Përmirësimi i aftësive të brendshme të NJIF-it për operativë dhe analiza;**
  - ✓ Objektivi specifik 3.1.: Zhvillimi, standardizimi dhe intensifikimi i proceseve të raportimit, inteligjencës dhe analize;
  - ✓ Objektivi specifik 3.2.: Promovimi i bashkëpunimit të agjencioneve për zbulimin dhe hetimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit;
  - ✓ Objektivi specifik 3.3.: Përforcimi i identifikimit, gjurmimit të ardhurave nga krimi/financimit të terrorizmit dhe ngrirja e aseteve
  
- **Prioriteti Strategjik 4 – Zhvillimi i legjislacionit Kombëtar për PPP/LFT;**
  - ✓ Objektivi specifik 4.1: Forcimi i legjislacionit Kombëtar për PPP/LFT;
  - ✓ Objektivi specifik 4.2: Forcimi i standardeve të brendshme të NJIF-K dhe sigurimi i implementimit të tyre efikas;
  - ✓ Objektivi specifik 4.3: Zhvillimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës ligjore dhe ofrimi i udhëzimeve për subjektet raportuese;
  
- **Prioriteti Strategjik 5 – Zhvillimi dhe aplikimi i qasjes proaktive ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar;**
  - ✓ Objektivi specifik 5.1: Forcimi i bashkëpunimit me NJIF homologe të huaj;
  - ✓ Objektivi specifik 5.2: Koordinimi mes NJIF-K dhe autoriteteve vendore për shkëmbimin e informacionit dhe ngritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar;
  - ✓ Objektivi specifik 5.3: Forcimi dhe ngritja e bashkëpunimit me vendet e rajonit;
  - ✓ Objektivi specifik 5.4: Bashkëpunimi me Egmont dhe të tjerët;
  
- **Prioriteti Strategjik 6 – Forcimi i kapaciteteve të NJIF-K**
  - ✓ Objektivi specifik 6.1: Rritja e kapaciteteve administrative të NJIF-K;
  - ✓ Objektivi specifik 6.2: Zhvillimi dhe forcimi i kapaciteteve të IT-së;
  - ✓ Objektivi specifik 6.3: Ngritja e kapaciteteve profesionale të stafit të NJIF-K



## Shtojca 1

Tabela e mëposhtme pasqyron pjesëmarrjen në trajnime/punëtori/vizita për vitin 2019:

|  | Trajnim/Punëtori/Vizitë  | Organizatori                | Vendi             | Numri i pjesëmarrësve |
|--|--|-----------------------------|-------------------|-----------------------|
| a. NJIF-K  | Konferencë për prezantimin e Ligjit të ri për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë           | B&S Project (BE)            | Prishtinë         | 2                     |
|  | Zbatimi Efikas i Sanksioneve të Synuara Financiare (Seminar Rajonal)                                       | Këshilli i Evropës          | Shkup, Maqedonia  | 2                     |
|  | Training program on Crime Intelligence Analysis  | UNODC - TADOC               | Ankara, Turkey    | 3                     |
|  | Trajnime mbi mbledhjen dhe analizën e Inteligjencës  | B&S Project (BE)            | Prishtinë         | 1                     |
|  | Punëtoritë në kuadër të procesit të Rishikimit Funkcional për Sektorin e Sundimit të Ligjit, faza e II-të, | Ministria e Drejtësisë      | Prishtinë         | 1                     |
|  | Regional Workshop - Performing Risk Assessments to Counter Terrorist Financing in the Non - Profit Sector  | Këshilli i Evropës          | Tivat, Montenegro | 2                     |
|  | Transnational Organized Crime, Money Laundering and Asset Forfeiture,                                      | Ambasada Amerikane          | Dubrovnik, Kroaci | 1                     |
|  | Punëtorit: Udhëzim për qasjen dhe mbikëqyrjen e bazuar në rrezik të inspektimeve për PPP/LFT               | PECK II                     | Prevallë          | 2                     |
|  | Case simulation exercise on cybercrime and financial investigations  | iPROCEEDS                   | Tiranë, Shqipëri  | 1                     |
|  | Hetimi i Krimeve Financiare  | UNODC-Akademia e Drejtësisë | Prishtinë         | 2                     |
|  | Punëtoritë për Procedurat Standarde në lidhje me Shpërndarjen e Inteligjencës                              | PECK II                     | Pejë              | 7                     |
| Sistemi për Menaxhimin dhe Arkivimin e Dokumenteve (SmAED) | IKAP   | Prishtinë                   | 2                 |                       |

|   |  |                            |    |
|---|--|----------------------------|----|
| Ekspert i Certifikuar i Forenzikes Financiare   | UNDP   | Prishtinë                  | 3  |
| Steering Committee Practical Information_ADVANCE PREPARATION  | PROCEEDS   | Bucharest, Rumani          | 1  |
| Punëtori për Pronësinë Përfituese në Kosovë   | PECK II  | Prishtinë                  | 2  |
| Korrupsioni publik, analiza e vlerës së pasurisë, shpëlarja e parave dhe konfiskimi i pasurisë                              | Departamenti i Drejtësisë i Ambasadës së SHBA-së në bashkëpunim me Programin Rajonal të Departamentit Amerikan të Drejtësisë | Zagreb, Kroaci             | 1  |
| Trajnim për rishikimin e workflows në goAML   | NJIF-K   | Prishtinë                  | 14 |
| Intermediate Intelligence Analysis and Informant Handling Course  | B&S Project (BE)   | Prishtinë                  | 2  |
| Illicit Trade   | Siracusa Institute   | Prishtinë                  | 2  |
| Operational Training Sessions Program - Typologies on Corruption  | Egmont Group   | The Hague, The Netherlands | 2  |
| Operational Training Sessions Program - ΣF3 – a proof of concept between domestic partners using the decentralized approach | Egmont Group   | The Hague, The Netherlands | 1  |
| Operational Training Sessions Program - ECOFEL's skills enhancement program: Advanced Strategic Analysis Course             | Egmont Group   | The Hague, The Netherlands | 1  |
| Operational Training Sessions Program - Flexible, Consistent Information Exchange Standards                                 | Egmont Group   | The Hague, The Netherlands | 1  |
| Operational Training Sessions Program - Small Cells, Lone Actors  | Egmont Group   | The Hague, The Netherlands | 1  |
| Vizitë Studimore në Europol   | Egmont Group   | The Hague, The             | 1  |

|  |                    |                                     |    |
|--|--------------------|-------------------------------------|----|
|  |                    | Netherlands                         |    |
| Vizite Studimore Vienë, Austri   | UNODC              | Vienne, Austri                      | 3  |
| Vizite Studimore, Lisbonë Portugali  | CEPOL              | Lisbonë Portugali                   | 1  |
| Valutat Virtuale, Pastrimi i parave dhe financimi i Terrorizmit  | CEPOL              | Tiranë, Shqipëri                    | 2  |
| Seminar: Cikli Kundër Mashtrimit, ndërlidhja midis parandalimit të Mashtrimit dhe Hetimeve   | AFCOS              | Shkup, Maqedonia                    | 1  |
| Vizite Studimore në Mbretërinë e Bashkuar (UK)   | PECK II            | Londër, UK                          | 4  |
| Launching of the Phase II of the Cof / EU Horizontal Facility Plogrm   | Këshilli i Evropës | Skopje, Republic of North Macedonia | 1  |
| Punëtori Dispozitat e reja penale për korrupsionin, standardet ndërkombëtare dhe zbatimin  | PECK II            | Prishtinë                           | 2  |
| Punëtori: shkëmbimin e përvojave ndërmjet dy institucioneve (NJIF-K dhe FIU Shqipëri) Përvojave dhe ngritjes së kapaciteteve institucionale. | FIU Shqipëri       | Korçë, Shqipëri                     | 16 |
| Mastering Anti-Money Laundering Training   | IFF/IFE/IIR MD     | Londër, UK                          | 2  |
| Kurs i Avancuar për Forenzik Financiare  | UNDP               | Prishtinë                           | 1  |
| Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për të gjitha organizatat buxhetore të nivelit qendror dhe lokal   | IKAP               | Prishtinë                           | 2  |
| AML/Confiscation Workshops   | UK Embassy         | Prishtinë                           | 1  |
| Konference rajonale  | UNODC              | Vienë, Austri                       | 3  |

Tabela 20: Aktivitetet e trajnimeve/punëtorive/vizitat nga stafi i NJIF-K për vitin 2019





Rr. EduardLir Nr.1 – Arbëri – Prishtinë, Kosovë

Tel: +381 38 247 105 – Fax: +381 38 247 103

<http://fiu.rks-gov.net>

fic@fic-ks.org